

Konferenca e Dytë Shkencore



**Roli i Institucioneve
Supreme të Auditimit në Menaxhimin e Përgjegjshëm Publik
Përballë Sfidave Aktuale**

12-13 XII 2013

**Albanian Supreme
Audit Institution** **ALSAI**

Second Scientific Conference

**The Role of the SAI-s
for an Accountable Public Management
in Today's Challenges**

Seria : botime KLSH 11/ 2013/21

Tiranë 2013



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit në menaxhimin e përgjegjshëm publik përballë sfidave aktuale

Konferenca e dytë Shkencore vjetore e KLSH-së
12-13 dhjetor 2013

Shqip-Anglisht

Seria: botime KLSH-11/2013/21
© Kontrolli i Larte i Shtetit
ISBN: 978-9928-159-18-2

Tiranë, 2013

Titulli:

“Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit në menaxhimin e përgjegjshëm publik përballë sfidave aktuale”

Redaktoi: Irena Islami

Alma Shehu

Art Design: Kozma Kondakçiu

Kjo Konferencë u organizua me iniciativën e KLSH-së dhe mbështetjen e Programit SIGMA

Seria: botime KLSH-11/2013/21

Shtypur në Shtypshkronjën “Mirgeeralb”, Tiranë

PËRMBAJTJA

Parathënie	5
Tematika e trajtuar	
I. Rëndësia e rritjes së rolit mbikëqyrës mbi financat e Shtetit të auditimit publik, parë në këndvështrimin edhe të kontekstit të krizës ekonomike mbarëbotërore	10
II. Transparenca dhe cilësia e informacionit për publikun si kushte të domosdoshme për forcimin e disiplinës financiare në sektorin publik	25
III.Ndërveprimi i auditimit të jashtëm me auditimin e brendshëm publik në funksion të mirëadministrimit dhe qeverisjes më të mirë	35
IV.Këshillimi dhe rritja e cilësisë audituese përmes auditimeve të performancës	40
V. Tema të tjera.	46
Konkluzione dhe rekomandime.	58
Aktivitete që shoqëruan Konferencën.	61

Parathënie

Në mbyllje të vitit 2013, Kontrolli i Lartë i Shtetit u fokusua në një drejtim tjetër të punës së tij, atë të kërkimit shkencor, nëpërmjet organizimit të Konferencës së Dytë Shkencore me temë *“Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit për një menaxhim publik të përgjegjshëm në sfidat e sotme”*. Ky aktivitet erdhi pas Konferencës së Parë Shkencore të KLSH, në dhjetor 2012, të titulluar *“77 vjet KLSH në 100 vite Shtet Shqiptar”*, e cila u përqëndrua në historikun dhe evoluimin në vite të këtij institucionit të rëndësishëm kushtetues.

Konferencën e nderuan me praninë e tyre rreth 120 pjesëmarrës nga SAI-t (Institucione Supreme të Auditimit) partnere dhe bashkëpunëtorët e huaj, këshilltarë të lartë të programit SIGMA, përfaqësues të institucioneve të tjera shtetërore, të botës akademike, të shoqatave të profesionistëve të fushës, të shoqërisë civile dhe mediave, auditues nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, etj.

Një moment i veçantë në zhvillimin e punimeve të konferencës ishte edhe fjala përshëndetëse e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, z. Ilir Meta, i cili nënvizoi rëndësinë e kësaj konference por njëkohësisht edhe rëndësinë e posaçme që ka institucioni kushtetues i Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili është *“ ..pjesë e pandarë e sfidës madhore për të garantuar për sot dhe për nesër akoma më shumë një qeverisje transparente e të përgjegjshme dhe për luftën kundër korrupsionit me qëllim instalimin e plotë të sundimit efektiv të ligjit në vendin tonë. Për Shqipërinë kjo është një sfidë që duhet vetëm të fitohet dhe kam besim të plotë që do ta fitojmë të gjithë së bashku”*.

Gjithashtu, z. Meta theksoi se *“...bashkëpunimi ndërinstitucional është një faktor kyç dhe çelës i suksesit për forcimin e sundimit të ligjit, për*

rritjen e mëtejshme të transparencës dhe thellimin e mirëqeverisjes dhe sidomos, për të garantuar ndëshkimin e paligjshmërisë. Ndaj, njoh dhe përshëndes kontributin në rritje që jep KLSH-së në këtë drejtim dhe kërkoj një bashkëpunim në rritje dhe angazhim edhe më të fortë e efektiv të gjitha hallkave ligj-zbatuese dhe të sistemit të drejtësisë”.

Në Konferencë u trajtuan gjatë dy ditëve 27 tema nga përfaqësues të SAI-ve, të bashkëpunëtorëve të huaj, vendas dhe nga auditues të KLSH-se dhe u përqendruan në këto drejtime kryesore :

- *Rëndësia e rritjes së rolit mbikëqyrës mbi financat e Shtetit të auditimit publik, parë në këndvështrimin edhe të kontekstit të krizës ekonomike mbarëbotërore*
- *Transparenca dhe cilësia e informacionit për publikun si kushte të domosdoshme për forcimin e disiplinës financiare në sektorin publik*
- *Ndërveprimi i auditimit të jashtëm me auditimin e brendshëm publik në funksion të mirëadministrimit dhe qeverisjes më të mirë*
- *Këshillimi dhe rritja e cilësisë audituese përmes auditimeve të performancës;*

Punimet shumë interesante, parë në këndvështrimin e eksperiencave të ndryshme dhe të faktorëve dhe aktorëve që lidhen me punën e SAI-ve i dhanë Konferencës nivel shkencor, interes dhe ngjallën debat.

Në konferencë u theksua nevoja që kanë Institucionet supreme të auditimit(SAI-t) që të shkëmbejnë mendime për gjetjet e auditimeve të tyre, të ndajnë metodologjitë e përparuara dhe të përfitojnë nga inovacioni në teknikat dhe përafrimet audituese të njeri-tjetrit. Kërkimi i aplikuar shkencor në auditimin publik e ndihmon pikërisht këtë nevojë të SAI-ve për progres dhe efikasitet të shtuar.

Ngjallën interes kumtesat e përfaqësuesit të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit të Komisionit Evropian për “Përgjegjshmërinë menaxheriale si parakusht për qeverisje të mirë dhe faktor kryesor për sigurimin e përdorimit të fondeve publike” dhe të përfaqësuesit të Gjykatës Evropiane të Audituesve për “Rëndësinë e rritjes së rolit mbikëqyrës mbi financat shtetërore të auditimit publik, në kontekstin e krizës ekonomike botërore”.

Vlerë të shtuar për këtë konference ishin edhe kumtesat e përfaqësuesve nga SAI-t partnere të Zyrës Kombëtare të Auditimit-NIK të Polonisë, të Gjykatës së Llogarive të Turqisë, të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë, të Zyrës së Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës, të Zyrës Shtetërore të Auditimit të Maqedonisë dhe veçanërisht të përfaqësuesve të SIGMA, etj.

Punimet e audituesve të KLSH-së në bashkëpunim me përfaqësues të botës akademike dhe të profesionistëve të kontabilitetit dhe të auditimit në vend sollen një panoramë origjinale të realitetit të sotem shqiptar në fushën e auditimit dhe më gjerë.

Mesazhi më i rëndësishëm që Konferenca përçoi ishte që auditimi kombëtar duhet të vihet në shërbim të qeverisjes kombëtare, për përmirësimin e menaxhimit publik financiar të vendit.

Organizimi i konferencave shkencore të KLSH-së është edhe pjesë e zbatimit të Strategjisë së institucionit për periudhën 2013-2017, ndër objektivat e së cilës janë “ Rritja e kapaciteteve audituese dhe e cilësisë së auditimit”, ku theksohet: “KLSH do të organizojë, duke filluar nga viti 2013, konferencën shkencore vjetore “Për auditimin e jashtëm publik në Shqipëri””, dhe “Rritja e ndikimit përmes Komunikimit dhe Bashkëpunimit”. Rritja e kapaciteteve audituese dhe e cilësisë së auditimit bazohet edhe në bashkëpunimin me SAI-t partnere dhe me botën

akademike e organizatat profesionale të fushës, bashkëpunim që u realizua më së miri përgjatë kësaj konference.

Tema dhe mesazhet qëndrore të këtij aktiviteti përkuan me rekomandimet e Kongresit të Pekinit të INTOSAI-t, INCOSAI XXI, në tetor 2013, mbi forcimin e kontributeve kombëtare dhe ndërkombëtare të INTOSAI-t dhe SAI-ve të vendeve të ndryshme për promovimin e qëndrueshmërisë së financave publike. Njëllon si Kongresi i fundit i INTOSAI-t, konferenca dha mesazhin se menaxhimi i shëndoshë i financave publike dhe politikat financiare të përshtatshme japin një kontribut të rëndësishëm në krijimin dhe mbajtjen e një klime financiare të favorshme. Në një linjë me INCOSAI XXI, Konferenca e KLSH kërkoi një harmonizim të kornizave të raportimit financiar në sektorin publik, duke dhënë më tepër transparencë në lidhje me veprimtaritë e qeverisë, në veçanti për sa i përket borxhit publik.

Punimet e Konferencës treguan edhe njëherë në praktikë suksesin dhe koherencën e motos së INTOSAI-it *“Experientia mutua omnibus prodest (Eksperiencia e Përbashkët ju shërben të gjithëve)*.

Konferenca e dytë Shkencore u organizua nga KLSH, me mbështetjen e Programit SIGMA përmes një ndihme modeste financiare dhe mbi të gjitha ekspertizës së z.Joop Vrolijk, Këshilltar i SIGMA-s.

Një falënderim i veçantë për z. Robert Gielisse, Drejtor Njësie në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit (DG-Budget) të Komisionit Evropian, i cili nderoi Konferencën me praninë dhe diskutimin e tij interesant, si dhe për z.Joop Vrolijk dhe z. Jacek Jezierski, të cilët pranuan propozimin tim dhe ishin bashkë-drejtues të kësaj konference shkencore.

Dëshiroj të falënderoj së fundmi të gjithë referuesit dhe bashkëpunëtorët e tyre nga fusha akademike, pjesëmarrësit dhe veçanërisht ata që ndihmuan

financiarisht për realizimin e konferencës si edhe stafin ndihmës për kontributin që dhanë në realizimin me sukses të saj.

Me bindje të thellë, tashmë mund të pohoj që Kontrolli i Lartë i Shtetit, do të vazhdoje punën e nisur në këto dy vite dhe në vjeshtë të vitit 2014 do të zhvillojë punimet Konferenca e Tretë Shkencore e KLSH-së. Sikurse theksoi z. Gielisse dhe bashkëdrejtuesit e Konferencës, *ky aktivitet mposhti muret e skpeticizmit nga mungesa e përvojës së SAI-t shqiptar dhe konturoi vlera shkencore në kumtesat që prezantoi dhe diskutimet ndaj gjetjeve dhe mesazheve të tyre.*

Bujar LESKAJ



**Konferenca e dytë Shkencore e KLSH-së
u fokusua në këto aspekte:**

- I. *Rëndësia e rritjes së rolit mbikëqyrës mbi financat e Shtetit të auditimit publik, parë në këndvështrimin edhe të kontekstit të krizës ekonomike botërore;*
- II. *Transparenca dhe cilësia e informacionit për publikun si kushte të domosdoshme për forcimin e disiplinës financiare në sektorin publik;*
- III. *Ndërveprimi i auditimit të jashtëm me auditimin e brendshëm publik në funksion të mirëadministrimit dhe qeverisjes më të mirë;*
- IV. *Këshillimi dhe rritja e cilësisë audituese përmes auditimeve të performancës*

I. Rëndësia e rritjes së rolit mbikëqyrës mbi financat e Shtetit të auditimit publik, parë në këndvështrimin edhe të kontekstit të krizës ekonomike botërore

Kjo tematikë tërhoqi në mënyrë të veçantë pjesëmarrësit e Konferencës për shkak të aktualitetit të mprehtë të saj, problematikës që mbart dhe interesit të lartë të qytetareve.

Kumtesat e Menaxherit të Programit në Gjykatën Turke të Llogarive, z. A. Ömer Karamollaoğlu dhe Audituesit të Lartë të Gjykatës Turke të Llogarive, z. Erdem Eller, u pritën me shumë interes dhe u vlerësuan nga pjesëmarrësit. Gjithashtu, rezultuan të suksesshme kumtesat e audituesve të KLSH-së të realizuara në bashkëpunim me përfaqësues të botës akademike, si kumtesa e Prof.Assoc.Dr. Manjola Naço & kandidatja Phd. Blerta Zilja, si edhe kumtesa e kandidatit Phd. Erton Kalessi & z.Drinold Sema.



Paneli Drejtues i Konferencës¹: Auditues i Përgjithshëm i ZAP të Kosovës, z.Lage Olofsson; Drejtor Njësie i DG Budget, Dr.Robert Gielisse; Kryetari i KLSH, z. Bujar Leskaj; Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Ilir Meta; Eksperti i SIGMA, z. Joop Vrolijk; Këshilltar i Presidentit të NIK të Polonisë, z. Jacek Jezierski

SAI-t luajnë një rol thelbësor në përgjegjshmërinë e menaxhimit publik dhe palët e interesuara u kërkojnë atyre të marrin një rol më aktiv në përmirësimin e mirë qeverisjes. Kjo rritje e rolit të SAI-ve vihet re dukshëm në Standardet e INTOSAI-t për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI) dhe në dokumente të tjerë të INTOSAI-t.

Në dhjetë vitet e fundit, INTOSAI ka krijuar dhe zhvilluar një kornizë që përmbledh ISSAI-t dhe INTOSAI GOVs, të cilët përmbajnë udhëzime për mënyrën se si duhen kryer auditimet dhe se si SAI-t duhet të vihen në shërbim

¹ Në të gjitha fotot e vendosura në këtë broshurë, renditja e emrave është bërë nga e majta në të djathtë.

të nevojave të ndryshme të palëve të interesuara. Si organ që vendos standard, INTOSAI u ka bërë thirrje anëtarëve të tij për përdorimin e kornizës ISSAI si një referencë e përbashkët për auditimin në sektorin publik,

si edhe të zbatojnë ISSAI-t në përputhje me mandatin dhe ligjet organike të SAI-ve përkatës.



Drejtor Departamenti në SAI e Maqedonisë, z. Branko Smilevski, Auditues i Lartë në SAI e Turqisë, z. Erdem Eller, Menaxher Programi në SAI e Turqisë, z. A. Ömer Karamolloaodlu, Audituese në KLSH, znj. Selime Bregu, zj. Yllka Pulashi, Eksperti i Mjedisit dhe Ekspert i Jashtëm në KLSH, Prof. Assoc. Dr. Sazan Guri.

Plani Strategjik i INTOSAI-t dhe Model i Zbatimit të ISSAI-ve i aprovuar nga Bordi Drejtues i INTOSAI-t në muajin tetor 2011, ka mandatuar IDI-n që të “japë mbështetjen e duhur për zbatimin e ISSAI-ve”. Për të përmbushur këtë mandat, IDI ka nisur një program gjithëpërfshirës për zhvillimin e

kapaciteteve i quajtur “Iniciativa e Zbatimit të ISSAI-ve” (program i 3 i-ve), i cili bazohet në disa “Mjete të Vlerësimit të Përputhshmërisë me ISSAI-t”, ose iCATs, për të matur përputhshmërinë me ISSAI-t ekzistues dhe për të identifikuar nevojat për zhvillimin e kapaciteteve.

Gjykata Turke e Llogarive ka qenë një nga vendet e para që ka zbatuar iCATs. Ky zbatim u vu në praktikë si një pjesë e “Projektit Kërkimor të ISSAI-ve”. Gjetjet fillestare të Gjykatës Turke të Llogarive në këtë projekt kanë identifikuar sasi të madhe dijesh të ndërthurura në kornizën e ISSAI-ve, e cila është e domosdoshme për përmirësimin e praktikës së auditimit. Megjithatë, mënyra se si ky informacion është strukturuar aktualisht në ISSAI-t, vendos disa sfida të rëndësishme :

- Kapërcimin e vështirësive sidomos të detajimeve dhe në disa raste, e paqartësive të standardeve ekzistuese në rastin e pajtueshmërisë së plotë me ISSAI-t;
- Për shkak fokusi të veçantë, si edhe të burimeve intensive dhe natyrës së fragmentuar, zbatimi i plotë i ISSAI-ve mund të mos përmbushë nevojat e SAI-ve apo palëve të interesuara.
- Kapërcimin e hendekut aktual midis nivelit të lartë dhe nivel të detajuar të ISSAI-ve, të cilët mund të kufizojnë SAI-t në arritjen e objektivave të përcaktuara në dokumentet e nivelit më të lartë, pasi puna në terren do të bëhet sipas standardeve të detajuara.

Korniza e ISSAI-ve është relativisht e re dhe ende në zhvillim e sipër. Prandaj sfidat e theksuara mund të interpretohen si karakteristikat e një faze të përkohshme. Gjithsesi, sfidat janë të vërteta dhe duhen trajtuar, nëse SAI-t duan të përmbushin rolin e tyre.

Politikat fiskale qeveritare ndikojnë drejtpërdrejtë në krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin ekonomik dhe gjenerimin e rritjes ekonomike. Për të siguruar qëndrueshmërinë e financave publike si dhe të borxhit publik në terma afat mesme dhe afat gjata, përputhshmëria dhe përgjegjësia e administratës janë të nevojshme. Por kompleksiteti i madh i kuadrit të rregullave gjithashtu krijon sfida të reja dhe rritja e numrit të rregullave, ndërveprimi i tyre dhe sofistikimi mund të komplikojnë zbatimin, si edhe të bëjnë pajtueshmërinë më të vështirë për t'u shpjeguar dhe monitoruar. Në këtë aspekt, auditimi i veprimtarisë qeverisëse duke harmonizuar veprimet përbën një rol parësor të SAI-ve në rritjen e nivelit të performancës së qeverisë. SAI-t në botë kanë për detyrë të harmonizojnë veprimet e tyre në nivel global për të realizuar këtë mision të rëndësishëm sidomos në kushtet e kësaj krize. Për këtë arsye, SAI-t e konsiderojnë të rëndësishme të bazojnë auditimet e tyre në rregullat fiskale (gjendja strukturore buxhetore, kufijtë e borxhit publik) së bashku me sistemet e planifikimit, transparencës dhe llogaridhënies. Qëndrueshmëria e financave publike ka të bëjë me politikën monetare dhe nën këtë këndvështrim SAI-t shqyrtojnë koordinimin aktual midis politikave fiskale dhe monetare duke patur si prioritet unifikimin e standarteve të auditimit dhe rritjen e rolit të SAI-ve për të audituar veprimtarinë e njësisve qeverisëse dhe për ti rekomanduar qeverive mënyra më të efektshme për tu përballur me vështirësitë dhe parregullsitë që sjell kriza në funksionimin e sistemit ekonomik.

Eksperiencia turke, tregoi rritjen e rolit mbikëqyrës të Gjykatës Turke të Llogarive mbi financat shtetërore nëpërmjet Raporteve të Transaksioneve të Thesarit si dhe shpjegoi efektet pozitive mbi brishtësinë e mishëruar në ekonomitë e prekura nga kriza ekonomike por pa harruar të ndalet në

sfidat që sjell harmonizimi në rolin në rritje të SAI-ve në auditimin e financave publike sidomos nën këtë kontekst.

Përvoja shqiptare dhe e Institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit në këtë drejtim ju përcoll Konferencës nëpërmjet punimeve të Drejtorit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit, Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme, z.Bajram Lamaj, Drejtorit të Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë, z.Ermal Yzeiraj & z.Koço Sokoli, z. Fatos Çoçoli & zj.Irena Islami, Drejtores së Departamentit të Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit zj.Albana Agolli, & Dr.Edvin Stefani.

Kriza financiare në vendet e Eurozonës, e shoqëruar me krizën e borxheve shtetërore, ka zgjatur 3-4 vitet e fundit dhe këto vende ende nuk kanë dalë plotësisht prej saj. Pasojat e kësaj krize kanë krijuar një “zonë vakum “ në ekonominë edhe të vendeve kufizuese ose periferike të Eurozonës, ku futet edhe Shqipëria. Faktorët ekonomikë që konfirmojnë situatën e krizës kishin të bënin me tre drejtime bazë, me ritmet e rritjes ekonomike që kanë një trend ngadalësues apo edhe rënës, në rritjen e nivelit të borxhit publik dhe në shfaqjen e paqëndrueshmërisë financiare dhe fiskale. Është i dukshëm dhe i prekshëm niveli i borxhit publik që ka pësuar një rritje të menjëhershme. Më pak i perceptueshëm për publikun por dhe një temë jo shumë e debatuar në qarqet kryesorë politike dhe ekonomike është ajo e destabilizimit monetar që normalisht do të reflektojë performancë jo të kënaqshme të qeverive në përmbushjen e objektivave makroekonomikë. Në këto kushte, duhet të ketë një presion të rëndësishëm që lind nga një nevojë qenësore për qeverisje më të mirë dhe shpenzimin më efektiv të parasë publike. Ndikimi i SAI-t tenton të lidhet ngushtësisht me menaxhimin më efektiv të financave publike, duke rritur besimin e konsumatorit dhe biznesit, transparencën dhe veçanërisht llogaridhënien.

Në përgjigje të këtij presioni, u theksua fakti që Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), në dy vitet e fundit ka shtuar me përparësi burime jo-konvencionale, duke dhënë një kontribut real me rekomandimet e tij, për rritjen e disiplinës financiare dhe të mirë-administrimit të burimeve publike. KLSH ka kërkuar dhe rekomanduar përgatitjen e një buxheti realist, vendosjen e një tavani kushtetues për borxhin publik në përqindje të PBB-së, dhe një politikë më të kujdesshme në manaxhimin e deficitit fiskal.



Zv/Auditues i Përgjithshëm i SAI të Maqedonisë, z. Naser Ademi; Drejtor Departamenti në SAI e Maqedonisë, z. Branko Smilevski, Auditues i Lartë në SAI e Turqisë, z. Erdem Eller, Menaxher Programi në SAI e Turqisë, z. A. Ömer Karamollaodlu, Audituese në KLSH, znj. Selime Bregu, zj. Yllka Pulashi, znj. Valentina Golemi, znj. Evis Kreshpaj, Ekspert i Jashtëm në KLSH, z. Fatos Çoçoli, Auditues në KLSH, z. Pjetër Beleshi.

Kjo krizë përveç borxhit të lartë publik dhe destabilizimit monetar ka sjellë edhe performancë jo të kënaqshme të qeverive në përmbushjen e objektivave makroekonomikë.

Globalizimi i ekonomisë dhe i problemeve të saj, kërkon një harmonizim të masave që duhen marrë nga të gjithë vendet e prekura nga kriza dhe ato

që rrezikojnë të preken nga kjo krizë. Kjo shprehet edhe në orientimet që jep Komisioni Evropian dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara. Si një instrument i rëndësishëm i parlamenteve demokratike, SAI-t të ndryshme në botë kanë për detyrë të harmonizojnë veprimet në nivel global. Ky bashkërendim ka si prioritet unifikimin e standarteve të auditimit dhe rritjen e rolit të SAI-ve për të audituar veprimtarinë e njëjësive qeverisëse dhe rekomanduar qeveritë për veprimtaritë e tyre. Relacionet midis veprimtarisë së qeverisë dhe krizës financiare janë të forta. Me veprimtarinë e saj qeveria, shfaqet në dy role; atë të konsumatorit final dhe atë të stimuluesit të prodhimit të brendshëm bruto. Politikat fiskale qeveritare ndikojnë drejtpërdrejtë në krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin ekonomik dhe gjenerimin e të ardhurave kombëtare. Në këtë aspekt auditimi i veprimtarisë qeverisëse nga SAI, duke harmonizuar veprimet përbën një rol parësor në reduktimin e korrupsionit, rritjen e nivelit të performancës së qeverisë dhe rritjen e mirëqenies së shoqërisë.

Përjasja e institucioneve të auditimi ndaj shoqërisë civile dhe implementimi i mekanizmave të transparencës dhe pjesëmarrjes në SAI është një fenomen i kohëve të fundit, ndërsa hulumtimi i transparencës nuk ka pasur vëmendje sistematike të këtyre praktikave. Ndërkohë, mekanizmat e pjesëmarrjes dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile janë një nga format që ndihmojnë SAI-t në tejkalimin e një pjese të pengesave që shfaqen në realizimin e rolit të tyre për shkak të kapaciteteve të kufizuara të burimeve njerëzore apo ekspertizës së lartë në trajtimin e çështjeve të caktuara. Në punimin e Prof.As.Dr Manjola Naco dhe Phd. kandidat Blerta Zilja u soll zbatimi i elementëve të këtyre mekanizmave në rastin e KLSH duke marrë në shqyrtimin secilin prej tyre, për të evidentuar hapat që janë hedhur në drejtim të transparencës dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile. Bazuar në elementët e njohur në literaturë të pjesëmarrjes, autoret paraqitën mënyrat se si shoqëria civile mund të

bashkëpunojë me SAI-t dhe aplikimi i tyre në rastin e KLSH. U theksua se shoqëria civile arrin të ndikojë në masë të madhe në përzgjedhjen e listës së institucioneve që auditohen, në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet ankesave, apo jo të drejtpërdrejtë, si përshembull nëpërmjet ndikimit që mund të ushtrojë në alokimin e fondeve të Buxhetit të Shtetit. Ndërkohë, ka një bashkëpunim në rritje vitet e fundit me OJQ dhe Institute, Institucione të Arsimit të Lartë dhe ekspertët nga më të mirët në fushën e auditimit, të cilët asistojnë KLSH-në në çështje të caktuara.

KLSH në raport me transparencën, duket se ka hedhur hapa të rëndësishëm drejt shpërndarjes së informacionit dhe vendosjes së tij në dispozicion të publikut. Në vitet e fundit vihet re një rritje e komunikimit aktiv me mediat. Raportet e auditimit dhe përfundimet e tyre kanë një hapësirë më të gjerë kohore në median e folur dhe janë bërë bërë pjesë e debateve televizive. Është rritur ndjeshmërisht numri i artikujve të KLSH-së, audituesve dhe bashkëpunuesve të saj në median e shkruar, ndërkohë që kanë nisur publikime të revistës shkencore të KLSH, tashmë 5 numra të saj për 2013; 40 auditues të KLSH kanë paraqitur idetë e tyre në mbi 135 shkrime në median e shkruar. Që prej vitit 2012, KLSH ka nisur me publikimin në faqen e internetit të raporteve të përmbledhura të çdo auditimi, ndërkohë që është pasuruar akoma më tej Raporti Vjetor i Performancës, duke rritur transparencën mbi aktivitetin e KLSH dhe profesionalizmit të tij. Lidhur me publikimin e përdorimit të fondeve nga vetë KLSH, Raporti Vjetori i Performancës jep një informacion të detajuar mbi përdorimin e buxhetit nga institucioni, ndërkohë që publikohen rregullisht Raportet e Monitorimit që dorëzohen pranë Ministrisë së Financave. Gjithsesi studime më të thelluara duhen ndërmarrë për të matur perceptimin e publikut kundrejt transparencës së veprimtarisë së KLSH-së.



Drejtor Departamenti në KLSH, z. Bajram Lamaj, Drejtore Departamenti në KLSH, znj. Albana Agolli, Sekretar i Përgjithshëm i KLSH, znj. Luljeta Nano, Kryetar i KLSH, z. Bujar Leskaj, Këshilltar i Presidentit të NIK të Polonisë, z. Jacek Jezierski

Ne Shqipëri, dhënia e pavarësisë së veprimit dhe rritja e autonomisë të njësive të qeverisjes vendore, ka sjellë në vëmendje domosdoshmërinë e vlerësimit të auditimeve që kryen KLSH në drejtim të administrimit dhe menaxhimit të aseteve të qëndrueshme që ato zotërojnë në territorin e tyre dhe krijimin e të mirave publike ndaj komunitetit. Nga auditimet e kryera konstatohen probleme sepse shfrytëzimi i këtyre aseteve është deri tani pa efektivitet dhe eficiensa është shumë e ulët, pasi produktet e tyre nuk po transferohen si të mira për komunitetin. Në kuadrin e decentralizimit nga qeveria, janë transferuar të gjitha pronat dhe asetet e qëndrueshme që kanë në territoret e tyre njësive vendore, por mungesa e shoqërimit të këtij transferimi me udhëzues të posaçëm apo me trajnime të punonjësve që do të punonin me administrimin dhe menaxhimin e tyre ka sjellë konfuzion. Vetë KLSH, duke e vlerësuar maksimalisht rëndësinë e këtij problemi, ka

kryer trajnim me audituesit e tij duke evidentuar auditimet cilësore brenda KLSH, por ka bashkëpunuar me ekspertë të fushave përkatëse për asetet (pyje, kullota dhe vepra ujore, etj) për të ndihmuar audituesit në rritjen e cilësisë së punës audituese dhe rezultatet janë të dukshme në zbatimin e rekomandimeve të KLSH në këtë drejtim.

Bashkëpunimi i KLSH-së me ekspertë të fushave të ndryshme, të shoqatave të profesionistëve të fushës, përfaqësuesve të botës akademike ka sjellë risi në punën e institucionit dhe ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e kapaciteteve audituese dhe për rrjedhojë në rritjen e cilësisë së auditimeve të realizuara. Bashkëpunime të tilla të frytshme kanë qenë ato me Prof.Dr.Skënder Osmanin, Prof.Dr. Omer Stringën, Prof.Dr.Jorgji Bollanon, Prof.Dr. Hysen Çelën, Prof.Assoc.Dr. Sazan Gurin, etj.

Objekti kryesor i veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit nuk është lufta kundër korrupsionit, por kontrolli ekonomik e financiar i fondeve të buxhetit të shtetit dhe miradministrimit të pronës shtetërore, por megjithatë roli dhe ndihma që KLSH ka dhënë në luftën kundër korrupsionit, sidomos përgjatë këtyre dy viteve të fundit, ka qenë mjaft e madhe. Kjo bazohet jo vetëm në numrin dhe nivelin e rekomandimeve të dhëna nga ana e KLSH në drejtim të parandalimit të fenomeneve korruptive, por edhe në numrin e konsiderueshëm të kallëzimeve penale të bëra pranë organit të prokurorisë për nëpunës të të gjitha niveleve të administratës shtetërore. Në dy vitet e fundit numri i kallëzimeve penale është rritur ndjeshëm, në vitin 2012 numri i tyre ka qenë 40 dhe në 2013 në 37 kallëzime të tilla. Nëse krahasojmë këto dy shifra me tre vitet e mëparshme (në 2009, 9 kallëzime; në 2010, 5 kallëzime; në 2011, 6 kallëzime) rezulton që kallëzimet penale janë rritur mesatarisht me 5.5 herë.

Përdorimi në rritje i shërbimeve dixhitale të përfshira në praktikën e përditshme të punës në dhjetëvjeçarët e fundit ka sjellë një botë të re për audituesit e brendshëm dhe të jashtëm në Shqipëri dhe sfidat e KLSH-së në këtë drejtim janë të mëdha. Tashmë ekziston një risi dhe sfidë jo vetëm për



qeverisjen efektive të infrastrukturës dhe menaxhimit të informacionit të ndjeshëm, por gjithashtu dhe për auditimin e frytshëm të tyre nga audituesit.

Shqipëria, vitet e fundit, nisi të ndjekë praktikën botërore për tu mbështetur në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit dhe realizimi i auditimeve në TI është një sfidë e natyrshme për KLSH. Në instancat qeveritare ku infrastruktura e Teknologjisë së Informacionit është një shtyllë themelore e proceseve të biznesit, Audituesit e TI duhet të sigurohet që të gjitha masat paraprake të nevojshme janë ndërmarrë dhe ata që janë përgjegjës janë të përcaktuar për çdo pjesë të strukturës, qoftë në termat e menaxhimit të infrastrukturës dhe shërbimeve, qoftë në menaxhimin e informacionit dixhital dhe bazave të të dhënave elektronike.

Audituesit e TI nevojitet të jenë të kualifikuar për të kryer vlerësimet e investimeve të kryera për objektivat e çdo institucioni. Ata gjithashtu mund të mësojnë si të kërkojnë për boshllëqet që mund të ekzistojnë në menaxhimin e infrastrukturës dixhitale apo të informacionit dixhital dhe përgjegjësitë e përcaktuara. Përveç këtyre, ekziston gjithashtu dhe mundësia e manipulimit të informacionit. Ndaj ka mjete dhe programe dixhitale që ndihmojnë Audituesin e TI të përshkojë të gjithë informacionin dixhital në institucione dhe të kontrollojë e nxjerrë të dhënat e gabuara, individë apo furnitorë që nuk ekzistojnë të regjistruar, data të gabuara apo shifra të shpenzuara mbi një kufi të caktuar me ligj, etj.

KLSH në fushën e auditimit të TI është ende në hapat e parë dhe në fazën përgatitore por ka objektiva të qartë në këtë drejtim. Në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH-së, *Zhvillimi dhe konsolidimi i auditimeve të Teknologjisë së Informacionit dhe përdorimi i TI në auditim* zë një vend të veçantë dhe përbën një nga objektivat prioritarë të kësaj strategjie.

KLSH synon të bëjë ndryshime themelore në përdorimin e teknologjisë së informacionit në punën e tij audituese dhe lehtësimin e personelit, i cili do të reflektohet në rritjen e dijeve të stafit të tij të auditimit, në cilësinë dhe në efikasitetin e punës audituese.

Konkluzione

- Të gjithë anëtarët e INTOSAI duhet të përdorin ISSAI si një referencë e përbashkët për auditimin në sektorin publik, si edhe zbatimin e tyre në përputhje me mandatin dhe ligjet organike të SAI-ve përkatës;



- SAI-t e konsiderojnë të rëndësishme të bazojnë auditimet e tyre në rregullat fiskale (gjendja strukturore buxhetore, kufijtë e borxhit publik) së bashku me sistemet e planifikimit, transparencës dhe llogaridhënies;
- Realizimi i auditimeve në TI është një sfidë për KLSH-në;
- Në kushtet e krizës aktuale botërore, nevojitet mbikqyrje e rritur e SAI-ve mbi veprimtarinë rregulluese financiare, në bashkëveprim me parlamentet e vendeve respektive, shoqërinë civile, botën akademike dhe mediat.
- Në bazë të standardeve ISSAI 5420 dhe ISSAI 5440 mbi menaxhimin e borxhit publik dhe dobësive fiskale, SAI-t të fuqizojnë auditimet mbi menaxhimin e borxhit publik dhe zbatimin e politikës financiare të Qeverisë dhe asaj monetare të Bankës Qendrore;
- SAI-t të kontribuojnë fuqimisht për themelimin e sistemit rregullator të financave publike të vendit, në ato vende ku ai nuk është themeluar;

- SAI-t të kontribuojnë në sistem për të shmangur krizën e mundshme, mosarritjen ose recesionin, që mund të shkaktohen nga rëndimi i pasojave të krizës së Eurozonës;
- KLSH të kërkojë me auditimet e tij bashkëpunim eficient mes anëtarëve të sistemit rregullator shqiptar të financave publike, duke ndarë eksperiencat e mirëfunksionimit të këtij sistemi në vendet e rajonit. Sistemi ka nevojë për mbikqyrjen e rritur të KLSH mbi veprimtarinë rregulluese financiare, në bashkëveprim me Kuvendin, shoqërinë civile, botën akademike dhe mediat.



II. Transparenca dhe cilësia e informacionit për publikun si kushte të domosdoshme për forcimin e disiplinës financiare në sektorin publik

Në trajtimin e kësaj teme të rëndësishme kontribuan Drejtor Njësie i DG-Budget, z. Robert Gielisse, Zv/Presidenti i NIK të Polonisë, z. Wojciech Kutyla, Anëtari i Gjykatës Evropiane të Audituesve, z. Neven Mates, Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, z. Lage Olofsson, Koordinatori Kombëtar i SAI të Bosnje- Hercegovinës, z. Hasan Sabanovic dhe Drejtor i Përgjithshëm në KLSH, znj. Helga Vukaj.

Ndryshimet në jetën ekonomike dhe shoqërore, nxisin ndryshimet në Qeveri, duke ndikuar në mënyrë të pashmangshme edhe punën e Institucioneve Supreme të Auditimit, si një prej elementëve kryesorë të mekanizmit të kontrollit qeverisjes.

Për të kryer misionin e ngarkuar nga Parlamenti, SAI-et kanë nevojë të kenë akses të pakufizuar ndaj informacionit, për të dhënë një informacion sa më të saktë rreth performancës së qeverisë, deviacioneve të konstatuara, pasojave të tyre dhe rekomandimet për përmirësimin e punës së qeverisë.

Qeverisja e mirë është art. Qeverisja e mirë në sektorin publik sigurohet kur ekziston Përgjegjshmëria Menaxheriale, e cila është një komponent kyç për qeverisjen e mirë. Zoti Robert Gielisse theksoi se *“Qeverisja e mirë ka të bëjë me respektimin e ligjit, duke vepruar në interes të publikut, integritetit, objektivitetit, përgjegjësisë menaxheriale, transparencës, ndershmërisë dhe tone at the top”*.

SAI është një agjent i Parlamentit dhe opinionit publik, që shqyrton punën e ekzekutivit, duke ofruar komunikim me Parlamentin dhe qytetarët.

Misioni i Institucioneve Supreme të Auditimit është rritja e rolit dhe

kontributit në drejtim të mirë-administrimit të financave publike, nëpërmjet kryerjes së kontrolleve cilësore dhe raportimit mbi rregullshmërinë dhe efektivitetin e përdorimit të të gjitha burimeve financiare shtetërore, në të mirë të shtetit dhe publikut në tërësi.

Për të kryer sa më mirë misionin e tij Institucioni Suprem i Auditimit duhet të jetë i hapur për komunikim dhe informim të ndërsjellë. Në kohën e zhvillimeve të shpejta të teknologjisë të informacionit, komunikimi mbetet një sfidë e vërtetë. Përgjegjshmëria për informimin e publikut është një detyrim për të shpjeguar dhe justifikuar punën e Institucioneve Supreme të Auditimit.

Mbështetur në Standardet INTOSAI, ISSAI 20: *“Pavarësia, përgjegjshmëria dhe transparenca e Institucionit Suprem të Auditimit janë parakushte thelbësore në një demokraci të bazuar në sundimin e ligjit dhe i mundësojnë këtij institucioni të udhëheqë me shembuj dhe të rrisë besueshmërinë. Transparenca është një forcë e fuqishme që kur aplikohet vazhdimisht mund të ndihmojë në luftën kundër korrupsionit, përmirësimin e qeverisjes dhe për të nxitur llogaridhënien. Nocioni i transparencës i referohet dhënies nga Institucioni Suprem i Auditimit të një raporti auditimi të besueshëm, të qartë dhe të rëndësishëm brenda statusit të tij, mandatit, strategjive, aktiviteteve, menaxhimit financiar dhe performancës. Përveç kësaj, ai përfshin detyrimin e raportimit publik mbi gjetjet dhe konkluzionet e auditimit dhe të eksedit publik ndaj informacionit rreth Institucionit Suprem të Auditimit”.*

Një eksperiencë e vyer në drejtim të komunikimit dhe informimit të opinionit publik mund të përfitohet nga NIK i Polonisë.

Njihen dy qëndrime që kanë të bëjnë me komunikimin e Institucioneve Supreme me opinionin publik:

- Qëndrimi “ tradicional” është ai që ka të bëjë me Komunikimi klasik, siç janë paraqitja në Parlament e Raportit Vjetor të punës së Institucionit Suprem të Auditimit, përgjigja ndaj letrave dhe ankesave të qytetarëve, sondazhet e opinionit publik, raportimi i rezultateve të këtyre sondazheve, etj.
- Qëndrimi “ i ri”, i cili pranon rolin e mediave si një rrjet të shpejtë shpërndarje të informacionit prej nga dhe mund të përfitohet në kohë reale edhe impakti ndaj punës së kryer nga Institucionet Supreme të Auditimit.



Zëvendës President i NIK të Polonisë, z. Wojciech Kutyla,, Sekretar i Përgjithshëm i KLSH, znj. Luljeta Nano, Zyrtare për Median e ZAP të Kosovës, znj. Qëndresa Mulaj.

Zoti Wojciech Kutyla gjatë kumteses së tij nënvizoi se:

“...Avantazhi i përdorimit të mediave kundrejt metodave tradicionale të informimit të publikut, konsiston në faktin sesa të interesuara janë mediat për lajmin “e ri”. Ato përdorin një gjuhë më të thjeshtë, duke e bërë më tërheqës lajmin dhe duke zgjuar në këtë mënyre interesin e një grupi më të gjerë individësh”.

NIK i kushton rëndësi të veçantë komunikimit dinamik dhe kërkesave bashkëkohore të medias. Falë Strategjisë së “Përgjigjes së Shpejtë” dhe disponibilitetit të përhershëm të Zyrës së Shtypit të NIK, ky institucion funksionon si një institucion i hapur për median dhe opinionin publik. Një ndër metodat që ka dhënë sukses është edhe “ Procesi i socializmit” : deklarata për shtyp dhe informacionet ju drejtohen gazetarëve të specializuara në një fushë ose njohës të subjektit të audituar Kjo metodë sjell ndryshim në mënyrën se si informohet publiku për punën e tyre. Takimet e rregullta me grupe të vogla të gazetarëve të ekspertëve, të cilat kanë zëvendësuar konferencat tradicionale për shtyp, kanë provuar që janë më efikase. Në takimet me gazetarët Presidenti i NIK dhe zëdhënësi për shtyp shpjegojnë në detaje çdo paqartësi lidhur me auditimet që kanë ngjallur interesin e medias. Si rezultat, materialet dhe artikujt e publikuar nga media janë gjithnjë e më të besueshme për publikun.

Një eksperiencë mjaft e vyer në këtë drejtim është eksperiencia e Gjykatës Evropiane të Audituesve dhe Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve anëtare të BE në informimin e qytetarëve të BE për përdorimin efektiv të buxhetit të BE.

Përgjegjshmëria publike dhe informimi sa më transparent i publikut janë vlera thelbësore të shoqërive demokratike dhe institucioneve të Bashkimit Evropian. Ato janë thelbësore :

- Për mbrojtjen e interesave financiare të qytetarëve të BE-së
- Për nxitje e besim tek BE dhe institucionet e tij
- Për të siguruar që fondet publike përdoren në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive për të përmbushur objektivat e BE-së në përputhje me rregullat e saj.

Kriza globale ekonomike dhe financiare ka pasur pasoja të mëdha për BE-në. Në përgjigje të saj, BE-ja ka marrë masa duke krijuar instrumente, organe dhe struktura të reja për daljen nga kriza dhe zbutjen e pasojave të saj.



Ekspert i SIGMA, z. Jose Viegas Ribiero, Drejtor Departamenti në KLSH, z. Rinald Muça, Administrator Projekti në SAI e Suedisë, z. Hazim Sabanovic, Drejtor i Marrëdhënieve me Jashtë në SAI e Rumanisë, z. Dragos Budulac, Anëtar i Gjykata Evropiane të Audituesve, z. Neven Mates(në këmbë), Auditues i Përgjithshëm i ZAP të Kosovës, z. Lage Olofsson; Drejtor i Njësisë i DG Budget, Dr.Robert Gielisse.

Në këtë kuadër janë shtuar sfidat dhe përgjegjësitë për transparencë të Gjykatës Evropiane të Audituesve. Kështu, theksi është vënë tek mbikëqyrja financiare e Autoritetit Bankar Evropian, Autoritetit Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve dhe Autoritetit Evropian të Tregut dhe Letrave me Vlerë. “ ECA ka përdorur një shumëllojshmëri metodologjish në auditim për të vlerësuar menaxhimin dhe për të monitoruar sistemet dhe informacionet. Kriteret janë nxjerrë nga legjislacioni dhe parimet e

menaxhimit të shëndoshë financiar. ECA ka përzgjedhur për të audituar ato subjekte të cilat ka të ngjarë të japin ndikim të lartë në ekonominë evropiane, duke rekomanduar dhe përmirësimet e mundshme për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit”- ka theksuar Anëtar i Gjykatës Evropiane të Audituesve, z. Mates.

Kriza financiare ka ngritur çështje të reja për auditimin publik në BE. Gjykata Evropiane e Audituesve është në procesin e kryerjen e auditimeve në : autoritetet e reja mbikëqyrëse, në mekanizmat e asistencës së garancisë së buxhetit të BE-së dhe aktivitetet të tjera të Komisionit Evropian.

Për Gjykatën Evropiane të Audituesve dhe Institucionet Supteme të Auditimit të vendeve të BE në përgjithësi ka hapësira për të luajtur rol të rëndësishëm në sigurimin e llogaridhënies publike dhe transparencë sidomos në fushën e standardeve të kontabilitetit dhe standardeve të auditimit të sektorit publik; në mbikqyrjen e aktiviteteve kryesore bankare dhe mbikqyrjen e politikave financiare që janë rrjedhojë e sistemit të ri rregullator.

Rritja e cilësisë së transparencës dhe llogaridhënies shtron para Institucioneve Supreme të Auditimit kërkesën për rritjen e kapaciteteve profesionale të audituesve. Një përgatitje profesionale sa më e mirë e audituesit rrit cilësinë e punës së tij dhe besueshmërinë në ekspertizën e raporteve të auditimit. Në një raport auditimi cilësor duhet të identifikohen lehtë nga publiku përzgjedhja e subjektit të auditimit, informacioni kryesor dhe gjuha e përdorur të jete sa më e kuptueshme.

Në ndihmë të konsiderueshme në rritjen e kapaciteteve profesionale të audituesve ka dhënë dhe jep njohja dhe implementimi i Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI). Zbatimi në praktikë i ISSAI, 20, 21, 30, përbëjnë parakushtet themelore për funksionimin

e duhur dhe sjelljen profesionale të Institucioneve Supreme të Auditimit si edhe parimet bazë për auditimin e subjekteve publike.

“Trajnimi i audituesve për njohjen dhe implementimin e ISSAI duhet të jetë një proces i vazhdueshëm. Mjaft e rëndësishme për një bazë solide profesionale janë atributet personale të audituesit. Ai duhet të jetë i aftë, kureshtar, komunikues, konkurrues, i guximshëm dhe i angazhuar. Implementimi dhe zbatimi i ISSAI-ve dhe trajnimi, sjell rritjen e cilësisë së punës së audituesve për një raportimit sa më të mirë mbi rregullshmërinë dhe efektivitetin e përdorimit të të gjitha burimeve financiare nga institucionet shtetërore” – nënvizoi Audituesi i Përgjithshëm i Kosovës, z. Olofsson.

Një eksperiencë të mirë në këtë drejtim ka Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës. Me Programin e Certifikimit të Audituesve, i cili aplikohet në katër fazat, të cilat janë: paraqitja e programit, pjesa përgatitore, certifikimi teknik dhe zhvillimi i mëtejshëm profesional është synuar që audituesit të mobilizojnë burimet e disponueshme dhe të bashkëpunojnë me kolegët më me eksperiencë për ti ndihmuar ata në zhvillimin e tyre profesional.

Si pjesë e rëndësishme e sfidave të një shteti ligjor duhet të konsiderohen edhe Whistleblowers. Whistleblowers, janë ata që sipas një definicioni të përshtatur nga anglishtja përfaqësojnë: *punonjësit e një institucioni publik ose privat që duke qenë në dijeni se në organizatën e tij zhvillohen praktika korruptive apo shkelje të tjera, ngre zërin pranë organeve kompetente për rastet në fjalë pa pasur ndonjë interes personal dhe në mbrojtje të së mirës publike. Ata besojnë se interesi publik qëndron më lartë se interesi i organizatës ky punojnë, e për këtë i “bien bilbilut, duke nxjerrë zë të fortë” për të nxjerrë në pah praktikat korruptive, anti-ligjore ose të dëmshme.*



Ish Drejtor Juridik në KLSH, z. Bashkim Spahija, Ish Kryetar i KLSH, Dr. Blerim Çela, Ish Kryetar i KLSH, z. Mustafa Kërçuku, Kryetar i IEKA, Prof. Assoc. Dr. Hysen Çela., Kryetar i KKK, Prof. Dr. Jorgji Bollano, Anëtar i Gjykata Evropiane të Audituesve, z. Neven Mates

Në këndvështrimin e mësipërm, KLSH mbetet e hapur - nisur nga vet pozitat e saj si nuhatës dhe ndjekës i rreziqeve me pasoja financiare dhe jo vetëm, - që të marrë rol aktiv vetëm në përputhje me kompetencat e saj kushtetuese, pa synuar ta transformojë rolin e tij në kapërcyes të kufijve të parashikimeve ligjore gjë që do ta tjetërsonte atë në një institucion të përngjashëm me Avokatin e Popullit.

Nën një tjetër optikë të pari, edhe vet KLSH në auditimet e saj, verifikuese, vlerësuese mund të thuhet se merr një rol zbulues përballë publikut të gjerë (në kuadër të publikimit të të dhënave që konkludohet se përbëjnë abuzim, shkelje ligjore etj). Pra vet roli i KLSH-së, është ai i denoncuesit,

i zë-përçuesit dhe kjo vjen ose bazuar në një tjetër bilbil-frurës/zë-nxjerrës ose drejtpërdrejt në kushtet e rastësisë audituese të risqeve të zakonta e të pazakonta.

Pra KLSH duhet të funksionojë vetëm mbi bazën e një parimi themelor, atë të interesit publik, i cili është prevalent ndaj çdo parimi tjetër. Për këtë arsye le të jenë organe të tjera, që të merren me ruajtjen e ekuilibrave mes asaj që ekspozohet dhe kategorizimit të klasifikuar të informacionit.

Konkluzione

Për rritjen e transparencës dhe cilësisë së informacionit për publikun është e domosdoshme:

- SAI-et duhet të informojnë publikun në lidhje me gjendjen e financave të shtetit dhe të japin llogari për aktivitetet e tyre;
- Hapja e administratës publike ndaj publikut;
- Promovimi i transparencës dhe efijencës në veprimtarinë e administratës publike;
- Institucionet të ndërveprojnë në emër dhe mbi bazën e një parimi themelor: interesit publik, i cili është prevalent ndaj çdo parimi tjetër.
- Implementimi dhe zbatimi i ISSAI-ve dhe trajnimi, sjell rritjen e cilësisë së punës se audituesve për një raportim sa më të mirë mbi rregullshmërinë dhe efektivitetin e përdorimit të të gjitha burimeve financiare nga institucionet shtetërore;
- Ne baze te Deklaratës se Limës, Neni 12,SAI-t duhet te bashkëveprojnë më thellësisht me boten akademike dhe shoqërinë civile, për rritjen e cilësisë dhe transparencës se informacionit;

- Në bazë të ISSAI 20, parimi 8, SAI-t të rrisin lejueshmërinë e raporteve dhe mesazheve të tyre në publik dhe në media, duke e bërë qytetarin pjesëmarrës të procesit të shëndoshjes së financave publike;
- Bashkëveprimi dhe aktivitetet e përbashkëta me shoqërinë civile (seminare, dëgjime publike, broshura, revista, faqe interneti, etj). sidomos me njësitë e saj të specializuara në ekonomi dhe financa, të jetë konkret dhe të synojë dhënien e një informacioni sa më të besueshëm për publikun e gjerë;
- SAI-t nuk duhet të ngurojnë të hyjnë me vendosmëri në mediat sociale dhe të investojnë tek ato kohën e audituesve më të mirë dhe që komunikojnë lirshëm në publik.

III. Ndërveprimi i auditimit të jashtëm me auditimin e brendshëm publik në funksion të mirëadministrimit dhe qeverisjes më të mirë

Në trajtimin e kësaj teme ishin me shumë interes kumtesat e Drejtorit të Njësisë së DG-Budget, z. Robert Gielisse, Këshilltarit të Lartë të SIGMA, z. Joop Vrolijk dhe Zv/Auditues i Përgjithshëm i SAI-it të Maqedonisë, z. Naser Ademi.

Referuesit theksuan se qeverisja e mirë në sektorin publik sigurohet kur ekziston Përgjegjshmëria Menaxheriale, e cila është një komponent kyç për qeverisjen e mirë. *“Përgjegjshmëria Menaxheriale ka të bëjë me mënyrën se si është duke u përdorur autoriteti për të arritur objektivat. Transparenca e autoritetit mund të jetë e jashtme, që do të thotë e hapura për shqyrtim e publikut dhe përgjegjesi e brendshme, e cila ka të bëjë me transparencën në lidhje me mënyrën se si janë arritur objektivat”*- nënvizoi z. Robert Gielisse.

Funksioni i auditimit forcon qeverisjen publike. Një nga elementet kryesore për një funksion auditimi efektiv të qeverisjes janë marrëdhëniet e shëndosha midis auditimit të jashtëm dhe të brendshëm. Ato varen nga pavarësia organizative, nga një mandat i qartë ligjor, qasja e pakufizuar e punonjësve, udhëheqja kompetente, stafi kompetent, mbështetje e aktorëve dhe standardet profesionale të auditimit.

Fushëveprimi i auditimit të brendshëm është që të sigurojë siguri objektive dhe të japë këshilla mbi veprimtarinë e menaxhimit, për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar funksionimin e njësisë ekonomike (duke përfshirë matjen e përputhshmërisë dhe të performancës: ekonominë, efikasitetin dhe efektivitetin). Fushëveprimi i auditimit të jashtëm është që të sigurojë siguri të arsyeshme mbi raportimin financiar, ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve.

“Marrëdhëniet ndërmjet auditimit të brendshëm dhe të jashtëm kërkojnë parandalimin e mbivendosjeve dhe dublimeve, për të reduktuar kërkesat në kohë të stafit të entitetit dhe për të zgjeruar perspektivën, duke krijuar një kulturë të përbashkët të auditimit në sektorin publik. Është në interesin e SAI-ve zhvillimi i pavarësisë së profesionit të Auditimit të Brendshëm, për të siguruar ndikim në zhvillimin e përgjithshëm të kontrollit të brendshëm financiar publik” - theksoi z. Vrolijk.



Fushat kryesore të bashkëpunimit qëndrojnë në zhvillimin e metodologjisë, standardeve dhe përcaktimeve, duke ndarë perspektivat për menaxhimin e riskut dhe vlerësimin e pasojave të futjes së auditimit të sistemeve/iniciativave të reja të Qeverisë.

Z. Gielisse nënvizoi gjithashtu se “ *palët e angazhuara për auditim mund të përqendrohen në Performancë, edhe pse kjo*

nuk mund të japë një opinion të përgjithshëm mbi ekonominë, efikasitetin dhe efektivitetin”.

Një diskutim konkret ne lidhje me dallimet midis Auditimit të Jashtëm dhe Auditimit të Brendshëm, planifikimi dhe strategjitë e tyre të auditimit, përzgjedhja e subjekteve që auditohen dhe mbi të gjitha rëndësia e bashkëpunimit mes këtyre auditimeve në Republikën e Maqedonisë ishte edhe ai i z.Naser Ademi, Zv/Auditues i Përgjithshëm i SAI-it të Maqedonisë.



Asistent i Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës, z. Ibrahim Gjylderen; Menaxher i Burimeve Njerëzore i SAI të Bosnje Hercegovinës, z.Enver Isanovic; Zv/Auditues i Përgjithshëm i SAI të Bosnje Hercegovinës, z.Dzevad Nekic;Zv/Auditues i Përgjithshëm i SAI të Maqedonisë, z. Naser Ademi; Drejtor Departamenti në SAI e Maqedonisë, z. Branko Smilevski Auditues i Lartë në Gjykatën turke të Llogarive, z. Erdem Eller

Auditimi i Jashtëm nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit, raporteve dhe dokumenteve të Auditimit të Brendshëm, procedurave të kontabilitetit dhe financave, të të dhënave elektronike dhe sistemit informatik dhe evidencave

të tjera vëren nëse raportet financiare paraqesin me vërtetësi dhe objektivitet, pozicionin financiar dhe rezultatin e aktiviteteve financiare të subjektit në pajtim me parimet e pranuar të kontabilitetit dhe standardet e kontabilitetit. Gjithashtu Auditimi i Jashtëm auditon edhe transaksionet financiare, të cilat paraqesin shpenzimet shtetërore në aspektin ligjor, për shfrytëzimin e mjeteve apo fondeve të dhëna me ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet.

Auditimi i Brendshëm duhet të jetë i pavarur dhe objektiv gjatë kontrollit të informacioneve dhe vërtetimin e saktësisë së tyre, dhënien e këshillimeve, me qëllim për të kontribuar në përmirësimin e punës së subjekteve.

Të tjera fusha bashkëpunimi mund të jenë:

- Takimet e rregullta për shkëmbimin e informacionit,
- Konsultimet mbi objektivat, strategjitë dhe aktivitetet,
- Testimi i programeve të IT,
- Ndarja e ekspertizës dhe shkëmbimet mes stafit, si edhe programet e përbashkëta të trajnimit.

Konkluzione

- Sinergjia ndërmjet auditimit të jashtëm dhe të brendshëm është prioriteti më i lartë në vendosjen e sistemit efikas të kontrollit të financave publike;
- Rolet janë të ndryshme, por bashkëpunimi midis Auditimit të Jashtëm dhe Auditimit të Brendshëm ndihmon të dy palët të arrijnë objektivat e tyre më mirë;
- Cilësia e punës së Auditimit të Brendshëm është e rëndësishme, por Auditimi i Jashtëm shërben për të vlerësuar efektivitetin e tij;

- Koordinimi dhe bashkëpunimi ofrojnë shërbim më efikas dhe efektiv për Institucionet për të cilat ata punojnë dhe, në fund të fundit për Kuvendin dhe publikun;
- Trajnimet e përbashkëta prodhojnë rezultate pozitive;
- Në bazë të Standardit ISSAI 9150, SAI-t dhe strukturat e auditimit të brendshëm duhet të forcojnë aftësitë e tyre të përbashkëta për të promovuar qeverisjen e mirë dhe praktikat e llogaridhënies, si dhe rritjen e të kuptuarit nga menaxhimi të rëndësisë së kontrollit dhe auditimit të brendshëm publik;
- Në bazë të Standardit ISSAI 9150, SAI-t dhe strukturat e auditimit të brendshëm duhet të promovojnë një kuptim më të qartë të roleve dhe kërkesave përkatëse të auditimit, si dhe një dialog të informuar për rreziqet me të cilat përballet institucioni dhe mbështetje reciproke për zbatimin e rekomandimeve të njëri-tjetrit.

IV. Këshillimi dhe rritja e cilësisë audituese përmes auditimeve të performancës;

Në trajtimin e kësaj teme kontribuan, Profesori i Fakultetit të Gjeologji-Minierave dhe Eksperti i jashtëm i KLSH, Prof. Dr. Skender Osmani, Profesori i Fakultetit të Ekonomisë dhe Eksperti i Jashtëm i KLSH, Prof. Dr. Omer Stringa, Pedagog në të Drejtën e Mjedisit, Prof. Ass.Dr. Sazan Guri, Rektor i Universitetit Politeknik të Tiranës, Akademik Jorgaq Kacani, Kryetare e Autoritetit të Konkurrencës, Prof.Dr. Lindita Lati, Eksperte Mjedisit, Msc. Marianthi Guri dhe Auditues në Kontrollin e Lartë të Shtetit, Msc. Ildir Dervishi.

KLSH ndodhet përballë kërkesës në rritje të opinionit publik për rritjen sasiore dhe cilësore të auditimeve dhe natyrshëm në këtë sfidë kërkohet një strategji me rrugë e metoda të reja dhe instrumente efikas. Futja e koncepteve të tilla *si auditimi në baze projekti* mund të jete një ide pararendëse e zhvillimeve të ardhshme të KLSH-së.

Kontrolli i Lartë i Shtetit kontrollon administrimin e pronës shtetërore dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në subjektet e përcaktuara me këtë ligj. Bazuar në detyrat e përcaktuara në ligj dhe praktikatat e deritanishme, auditimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit janë përqendruar në pjesën më të madhe në përputhshmërinë e aktivitetit financiar të subjekteve. Megjithëse çështjet e rregullshmërisë në aktivitetin financiar janë një komponent i rëndësishëm në kontrollin e përdorimit të fondeve publike, ky komponent është i pamjaftueshëm në vetvete për të siguruar që administrimi financiar në subjektet publike është eficient. Një vlerësim i drejtë mbi administrimin e fondeve publike do të kërkonte që auditimet e kryera nga KLSH të fokusoheshin përtej çështjeve të përputhshmërisë dhe kontrolleve financiare me qëllim shtimin e vlerës për publikun dhe taksapaguesit.



*Audituese në KLSH, znj. Evis Kreshpaj, Prof.Dr.Skënder Osmani,
Kryeauditues në KLSH, z. Gjovalin Preçi; (Në rreshtin e dytë) Auditues
në KLSH, z. Artan Topjani, znj. Mimoza Bedini, znj. Kejda Muça.*

Për t'ju përgjigjur sa më mirë sfidave që sjell zhvillimi ekonomik i vendit, zhvillimi i teknologjisë së informacionit dhe për të përmbushur sa më mirë detyrat e përcaktuara në ligj, nga KLSH kërkohet zhvillimi i auditimeve që vlerësojnë përmbajtjen dhe jo vetëm formën e aktivitetit të subjekteve publike ose siç njihen ndryshe “Auditim i Performancës”.

Auditimi i Performancës ka si qëllim kryesor ekzaminimin e një ose më shumë aspekteve të mëposhtëme :

- Veprimtarinë ekonomike në përputhje me parimet dhe praktikatat e shëndosha të administrimit;

- Efikasitetin e përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe të tjera, duke përfshirë ekzaminim të sistemeve të informacionit, treguesve të performancës, si dhe procedurat që ndiqen nga subjektet e audituara për të ndrequr mangësitë e identifikuara; dhe
- Efikasitetin e veprimtarisë së subjektit në përmbushje të synimeve për të cilat është krijuar.

Që prej fundit të viteve '90, në vendet e zhvilluara si Australi, Kanada, Finlandë, Francë, Holandë, Norvegji, Suedi, Britani e Madhe dhe SHBA, auditimi i performancës është pjesë e pandarë e aktivitetit të organizatave/njësive qeveritare dhe luan një rol të rëndësishëm në vlerësimin e përgjegjshmërisë së mirëqeverisjes. Eksperiencia e këtyre vendeve tregon se auditimi i performancës nxit një menaxhim më efikas dhe më të shëndetshëm të financave publike. Auditimi i performancës shihet si një aktivitet i ndërlikuar dhe jo fort i qartë, krahasuar me auditimin financiar, pasi është i vështirë për t'u standardizuar dhe për ta realizuar në mënyrë të sukseshme kërkohet një larmi aftësish dhe kualifikimesh.

Në përmbushje të qëllimeve të tij, auditimi i performancës në përgjithësi ndjek një rën prej tri qasjeve të mëposhtme në vlerësimin e performancës së subjektit publik nën auditim:

- Qasja që i kushton vëmendje arritjes së qëllimeve të vendosura - për të vlerësuar masën deri ku janë arritur ato dhe analizuar shkaqet e mos realizimeve të mundshme;
- Qasja që i kushton vëmendje funksionimit efikas të sistemeve të menazhimit;
- Kombimin i dy qasjeve të mësipërme.

Auditimi i Performances bëhet edhe më i rëndësishëm në rastin e auditimit të punëve publike pasi nga njëra anë investimet në vepra publike apo shpenzimet për mirëmbajtjen e tyre shihen gjerësisht si të një rëndësie të veçantë në përmirësimin e cilësisë së jetesës, rritjen e efijencës, produktivitetin ekonomik dhe stimulimin e punësimit dhe ana tjetër këto vepra duhen financuar dhe përbejnë kosto për qytetarët. Duke pasur parasysh rëndësinë sociale dhe ekonomike të punëve dhe veprave publike, subjektet përgjegjëse për to duhet të jenë subjekt i rregullt i auditimeve.

Auditimi i performancës merret me aspekte të ndryshme të auditimit të sektorit publik dhe si rrjedhojë është i vështirë krijimi i standarteve të detajuara dhe të përshtashme që do të mbulonin të gjitha këto aspekte.

Auditimi i performancës duhet të fokusohet në kryerjen e një analizë objektive të bazuar në dëshmi të përshtatshme me qëllim vlerësimin e objektivave, programit, aktivitetit dhe veprimtarisë së subjekteve përgjegjëse për punët publike. Përfundimet dhe rekomandimet e auditimit të performancës duhet të ndihmojnë drejtuesit dhe administratorët e subjekteve për të mirëqeverisur, përmirësuar anët operacionale, rritjen e efijencës për shpenzimet dhe investimet publike me qëllim rritjen e vlerës së shtuar për qytetarët dhe taksapaguesit.

Raste mjaft specifike të auditimit të performancës përbëjnë auditimi i projekteve inxhinierike dhe auditimi i projekteve të ruajtjes së mjedisit.

Kështu, projektet inxhinierike janë një përjashtim i veçantë i aktiviteteve të tjera prodhuese, sepse janë tepër unikë dhe shumë pak repetitivë gjatë procesit të realizimit të tyre, për t'u trajtuar sipas metodave standarde të menaxhimit dhe kontrollit. Në kushte të tilla, auditimi i projekteve inxhinierike të projektuara dhe zbatuara sipas teknikave të avancuara ekonomiko-inxhinierike, është

një sfidë e rëndësishme, e cila me globalizimin e ekonomisë dhe avancimin e teknikës, kërkon qasjen e duhur sipas kontekstit ekonomik dhe kohor. Një ndihmë e madhe në auditimin e projekteve inxhinjerike mund të jetë përdorimi i Metodës së Vlerës së Fituar, pasi me të mund të kryejmë kontrollin e integruar të kostos dhe avancimin e një projekti inxhinjerik. Ajo është gjithashtu një metodë shumë e mirë për llogaritjen e performancës së projektit, sepse pasqyron në mënyrë kuantike dhe të qartë se si projekti ka performuar dhe do të performojë në të ardhmen.

Në rastin e auditimeve të projekteve për ruajtjen e mjedisit mund të përmendim Auditim për performancën e menaxhimit të mbetjeve urbane në një njesi vendore të caktuar. Synimi i auditimit të menaxhimit të mbetjeve urbane duhet të japë një panoramë të përgjithshme të funksionimit të Strategjisë Kombëtare të Mbetjeve Urbane dhe të përshkruajë konkretisht instrumentet dhe realizimin e saj në njësitë vendore (bashki, komunë....).

Auditimi i Performancës duhet të synojë dhënien e një panorame sa më të qartë mbi gjendjen e menaxhimit të mbetjeve urbane, grumbullimit të tyre, trajtimit, reduktimit, riciklimit, kompostimit dhe grososjes, me qëllim përmirësimin e këtyre proceseve në të ardhmen, të cilat ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në mjedisin përreth dhe në shëndetin e popullsisë.

Konkluzione

- Shoqëria jone kërkon nga KLSH të rrisë auditimin në gjerësi e thellësi dhe të realizojë një vlerësim sa më të saktë të performancës
- Auditimi i Performancës në subjektet përgjegjëse për punët publike duhet të arrijë misionin e tij, atë të vlerësimit të plotë të veprimtarisë së subjektit, për të identifikuar mundësitë për përmirësim e

efikasitetit operacional dhe ekonomik, si dhe mundësitë praktike për rritjen e cilësisë së investimeve dhe shërbimeve;

- Auditimi i performancës është pjesë e pandarë e aktivitetit të organizatave/njësive qeveritare dhe luan një rol të rëndësishëm në vlerësimin e përgjegjshmërisë së mirëqeverisjes.

V. Tema të tjera të trajtuara në Konferencë.

Këshilltar i Presidentit të Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë (NIK), z. Jacek Jezierski; Eksperti i SIGMA, z. José Viegas Ribiero; Kryetari i Këshillit Kombëtar të Kontabilistëve, Prof. Dr. Jorgji Bollano; Kryetari i IEKA, Prof. Dr. Hysen Çela; Sekretari i Përgjithshëm i KLSH, znj. Luljeta Nano dhe Përgjegjëse Sektori në KLSH, znj. Albana Gjinopulli, kontribuan në këtë konferencë me tema të spikatura dhe trajtuan çështje të veçanta.



Drejtore Departamenti në KLSH, znj. Manjola Naço; Kryetari i KLSH, z. Bujar Leskaj, Drejtore Departamenti në KLSH, z. Rinald Muça; Ekspert i SIGMA, z. Joop Vrolijk; Këshilltar i Presidentit të Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë (NIK), z. Jacek Jezierski

Analiza e riskut ishte një nga temat e diskutuara gjerësisht në Konferencë. Analiza e riskut i shërben auditimit për të përcaktuar prioritetet e tij për vitin e ardhshëm (ose për të mbajtur prioritetet e mëparshme, nëse janë akoma të vlefshme) dhe për të përgatitur tema të reja të propozuara për auditim, të cilat lidhen me ato zona ku risku për parregullsi është shumë i lartë.

Zoti Jezierski në punimin e tij thekson se : *“..një problem social dhe ekonomik që duhet audituar vihet në dukje së bashku me riskun e lidhur me të. Subjektet, aktivitetet e të cilëve mund të influencojnë identifikimin e riskut specifikohen. Po ashtu specifikohet edhe mënyra se si janë përzgjedhur të audituarit (rastësisht, me qëllim), efektet e parashikuara të auditimit (vlerë e shtuar) risqet kryesorë....etj”*

Nga eksperiencia e NIK të Polonisë, në pjesën e parë të vitit, në bazë të analizës së riskut, hartohet dokumenti “Udhëzimet Teknike dhe Organizative për Planin e Punës së NIK”. Ky dokument përveçse përcakton parimet, itinerarin dhe kalendarin e aktiviteteve të planifikuara, përmban dhe rezultatet e analizës së riskut, duke përfshirë edhe zonat e mundshme për auditim. Për më tepër, ai specifikon prioritetet audituese, vendos limitet e ngarkesës së punës dhe kohë zgjatjen e auditimeve të planifikuara, duke përfshirë edhe formën preliminare të temave të auditimit.

Analiza e riskut që kryhet për procesin e planifikimit të NIK-ut përbëhet nga disa elementë. Qëllimet kryesore të analizës së riskut në procesin e planifikimit janë:

- Selektimi i risqeve më të rëndësishëm në funksionimin e shtetit që mund të pengojnë realizimin e qëllimeve kushtetuese;
- Vlerësimi i rëndësisë së tyre;

- Përcaktimi i prioriteteve të auditimit për planifikimin e vitit respektiv;
- Optimizimi i përcaktimit të temave të planifikuara të auditimit.

Auditimi i fondeve të BE sipas metodës së auditimit të sistemeve ose kampjonimit të objekteve të auditimit ka si qëllim të sigurojë dëshmi për opinionin vjetor që do të hartohet nga Autoriteti i Auditimit mbi:

- funksionimin e menaxhimit dhe të sistemit të kontrollit;
- cilësinë e pagesave,
- ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve deklaruar në Bruksel.

Puna e nevojshme për të nxjerrë opinionin vjetor të auditimit përfshin nevojën për të audituar një mostër statistikore të operacioneve. Zgjedhja e metodës së mostrës është bazuar kryesisht në ndryshueshmërinë e gabimeve dhe marrëdhëniet e tyre me shpenzimet.

Opinionet e pakualifikuara mund të hartohen vetëm nëse shkalla e gabimit është nën materialitetin (2%, e nivelit të besueshmërisë).



Ekspert i SIGMA, z. Jose Viegas Ribiero (në këmbë), Drejtor i Marrëdhënieve me Jasthtë në SAI e Rumanisë, z. Dragos Budulac(ulur).

Në përfundim të auditimit sipas metodës së kampioneve mund të gjendemi para tre situatave:

- Situata I: Limiti i sipërm i gabimit është më pak se gabimet e pranueshme. Rezultati i pranueshëm (opinion i pakualifikuar);
- Situata II: Kufiri i sipërm i gabimit e tejkalon gabimin e pranueshëm, por mundësia e gabimit të mundshëm është më e vogël se gabimi i pranueshëm (veprime të mëtejshme - kërkohet punë shtesë auditimi);
- Situata III: Gabimi i mundshëm tejkalon gabimin e pranueshëm. Popullsia është e papranueshme (opinion i kualifikuar)

Një ndërhyrje e pritur me interes ishte edhe ajo e zj.Susanne Flynn, përfaqësuese e FMN në Tiranë. Kriza fiskale e viteve '90 vuri në dukje dobësitë në raportimin financiar publik dhe privat dhe theksoi risqet që kanë të bëjnë me lidhjet mes dy palëve. Kjo krizë i nxiti qeveritë e vendeve të ndryshme dhe organizatat ndërkombëtare të punojnë për rishikimin e Kodit të Transparencës Fiskale.

Objektivat e kryesore të këtij rishikimi ishin:

1. Theksimi i cilësisë dhe besueshmëria e informacionit të publikuar;
2. Përditësimi i parimeve dhe praktikave, për të reflektuar mësimet e nxjerra nga kriza;
3. Grupimi i parimeve dhe praktikave që kanë standardet më të rëndësishme ndërkombëtare (GFSM 2001, IPSAS, Parimet e OSBE-se, PEFA);
4. Ofrimi i një pakete udhëzimesh për mënyrën se si të bëjnë përpara

për të arritur përputhshmërinë e plotë me standardet ndërkombëtare.



Përfaqësuese e Misionit të FMN në Shqipëri, znj. Susanne Flynn, Drejtor i Përgjithshëm në KLSH, znj. Helga Vukaj, Sekretar i Përgjithshëm i KLSH, znj. Luljeta Nano, Kryetar i KLSH, Z. Bujar Leskaj.

Rishikimi dhe implementimi i Kodit të Transparencës Fiskale do t'ju ofrojë qeverive një set të ri parimesh për raportimin financiar i cili mbulon: raportet fiskale të të gjitha njësive ekonomike që kryejnë veprimtari publike sipas standardeve ndërkombëtare; raportet fiskale të konsoliduara të gjitha entiteteve të qeverisë qendrore dhe nën sektorëve të tij; raportet fiskale që mbulojnë të gjitha të ardhurat publike, shpenzimet dhe

financimet; raportet fiskale që mbulojnë flukset e mjeteve monetare, të ardhurat, shpenzimet dhe flukset e tjera.

KLSH në këtë fund viti botoi në shqip “*Standartet e Auditimit të Borxhit Publik (ISSAI 5410-5440)*”.



- ISSAI 5410- Udhëzimi për Planifikimin dhe realizimin e një Auditimi mbi Kontrollin e Brendshëm
- ISSAI 5411- Indikatorët e Borxhit
- ISSAI 5421- Një Udhëzimi për termat e referencës në Kryerjen e Auditimit të Performancës së Buxhetit Publik
- ISSAI 5422- Udhëzues mbi Përkufizimin dhe Publikimin e Borxhit.
- ISSAI 5440- Udhëzimi për Kryerjen e Auditimit të Borxhit Publik- Përdorimi i Testeve të Pavarura në Auditimin Financiar

Një rëndësi të veçantë dhe një risi për Konferencën e II-të Shkencore të KLSH përbën dhe trajtimi i temës “Instrumenti i vetëvlerësimit të integritetit të SAI-t - Profili i menaxhimit të sistemit të kontrollit të integritetit të KLSH”.

Objekti i Integritetit ka të bëjë me “sjelljen etike”. Ky objekt është i rëndësishëm pasi përcakton drejtimin dhe orientimin e metodave dhe politikave që do të ndiqen drejt parandalimit, drejt qeverisjes së mirë (trajtimi i integritetit) apo dhe drejt qeverisjes nëpërmjet ndëshkimit (vija e ashpër antikorrupsion).

Dilema në këtë rast është: *një qeverisje e mirë*- trajtimi i integritetit, ndërgjegjësimi me fokus tek parandalimi i shfaqjeve korruptive apo një

qeverisje ndërmjet ndëshkimit - vija e ashpër bazuar në kodin penal, hetimin dhe ndëshkimin.

Zgjidhja më e mire do të ishte një trajtimi i balancuar që çon në parandalimin e këtyre fenomeneve duke përdorur presionin e ligjit.

Integriteti i Institucionit Suprem të Auditimit është element thelbësor dhe parakusht që ky institucion të konsiderohet i besueshëm. Duke ju referuar misionit kushtetues të KLSH, instalimi i një sistemi efektiv integriteti merr një rendësi të veçantë për këtë institucion. Ndër masat që duhen marrë është instalimi i një infrastrukture efektive etike dhe reagimi ndaj incidenteve dhe shkeljeve të integritetit.

Hapat kryesore që duhen hedhur janë:

- Hartimi i një kuadri rregullator (rregullore, urdhra, udhëzime, etj);
- Implementimi dhe zbatimi i procedurave, rregullave dhe standardeve;
- Trajnimi i punonjësve me frymën e standardeve dhe vlerave morale;
- Procedimi me hetimin, zbulimin dhe ndëshkimin e sjelljeve të papranueshme të integritetit .

Në strategjinë e KLSH për vitet 2013- 2017 është parashikuar hartimi i Manualit të Auditimit të Integritetit. Prioritet për KLSH do të jetë gjithashtu edhe ngritja e strukturës së investigimit dhe komunikimit me publikun dhe përkthimi i standardeve dhe praktikave më të mira në këtë fushë.

KLSH është pranuar në qershor të vitit 2013, anëtare e grupit Task Force

të EUROSAT-it për “Auditimin dhe Etikën” (TFA&E), në nën-grupin e 3-të të kësaj Task Force për *Auditimin e Etikës në Institucionet e tjera Publike*.

KLSH synon ti japë publikut një garanci dhe një transparencë të plotë në lidhje me menaxhimin e sistemit të integritetit. Kjo është realizuar deri tani nëpërmjet publikimeve në faqen Web të :

- Raporteve të performancës institucionale;
- Publikimit të analizave vjetore dhe periodike të veprimtarisë së KLSH-së;
- Publikimit i masave të marra ndaj audituesve që kanë rezultuar me shkelje të integritetit;

KLSH synon të përfshijë në programet e auditimit kryerjen e auditimit të integritetit dhe etikës në veprimtarinë audituese si dhe ndërgjegjësimin e sektorit publik për INTOSAINIT dhe përdorimin e këtij instrumenti.

KLSH ka ngritur një sistem efektiv të kontrollit të integritetit dhe një infrastrukturë etike efektive dhe kontribuon duke udhëhequr sipas shembullit në promovimin e integritetit në sektorin publik dhe rrjedhimisht për një qeverisje të mirë.

Nga ekspertët më të njohur kontabilistë në vendin tonë u trajtuan temat mbi njohjen e zhvillimeve aktuale të raportimit financiar, standardet ndërkombëtare të auditimit dhe përdorimi i tyre në auditimin e pasqyrave financiare.

Kontabiliteti dhe auditimi financiar nuk mund të shihen të ndarë nga njëri tjetri. Zhvillimet që ndodhin në secilin prej tyre shihen të integruara. Qëllimi

i tyre është ofrimi dhe garantimi i një informacioni financiar të drejtë e të besueshëm në funksion të vendimmarrjes dhe në shërbim të interesit publik. Kjo arrihet vetëm duke implementuar standardet më bashkëkohore si të raportimit ashtu dhe të auditimit.



Audituese në KLSH, znj. Nikoleta Piranjani, Drejtore Departamenti në KLSH, znj. Manjola Naço, Kryetare e Autoritetit të Konkurrencës, Prof.Dr. Lindita Lati, Përgjegjëse Sektori në KLSH, znj. Albana Gjinopulli, Audituese në KLSH, znj. Valdete Berisha. Në rreshtin e dytë Auditues në KLSH, z.Bexhet Zeqiri, z. Ymer Stafa, z.Andrea Kristo, z. Besim Bileri.

Një nga përdoruesit e jashtëm të informacionit kontabël është edhe KLSH. Sipas ligjit që rregullon veprimtarinë e tij, KLSH ka si objekt kryesor auditimin e përdorimit efektiv dhe të dobishëm të fondeve publike, zhvillimin e mirë-administrimit financiar si dhe auditimin e zbatimit të ligjshmërisë në fushën ekonomike dhe atë financiare. KLSH dhe Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, si organizma publike dhe të pavarur, duhet të bashkëpunojnë ngushtë për

arritjen e qëllimit final në administrimin e fondeve dhe pronave publike.

Për këtë qëllim është i nevojshëm:

- Implementimi i risive në secilën prej të dyja fushave;
- Kontributi i drejtpërdrejtë i KLSH në mbikëqyrjen e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (pra jo vetëm të ligjit të buxhetit) për ato njësi ekonomike tregtare ku shteti mban më shumë se 50% të aksioneve;
- Edukimi i vazhdueshëm i audituesve, jo vetëm në standardet e auditimit por edhe në standardet e kontabilitetit;

Në vitin 1969 një Grup Studimor Ndërkombëtar i Kontabilistëve krahasoi praktikat e auditimit në Kanada, Britaninë e Madhe dhe SHBA dhe konstatoi mënyra dhe metoda të ndryshme auditimi. Nevoja për unifikimin e praktikave të auditimit çoi në krijimin e Bordit Ndërkombëtar të Hartimit të Standardeve të Auditimit (IAACB), bord i pavarur nga federata Ndërkombëtare e kontabilistëve (IFAC). Misioni i IAACB ishte :

- Hartimi i standardeve cilësore të auditimit, rishikimi, dhënia e sigurive të tjera dhe kontrolli i cilësisë;
- Ndihmesa për konvergimin apo zvogëlimin e ndryshimeve midis standardeve ndërkombëtare e atyre lokale/kombëtare;
- Përmirësimi i cilësisë së auditimit në mbarë botën dhe forcimi i besimit të publikut tek raportimi financiar.

Pasqyrat Financiare të entiteteve të sektorit publik janë për qëllime të përgjithshme. Ato përdoren nga ligjvënësit dhe departamentet qeveritare, investitorët vendas e të huaj, kreditorët, publiku i gjerë, por edhe nga përdorues të tjerë. Ndryshe nga sektori privat pasqyrat financiare të entiteteve të sektorit

publik mund të përfshijnë edhe informacione shtesë si p.sh. informacione që bëjnë të mundur krahasimin e shpenzimeve të periudhës raportuese me shifrat e buxhetuara apo me limitet e përcaktuara me ligj.

Për të marrë sigurinë e arsyeshme për treguesit financiarë, Pasqyrat Financiare duhet t'i nënshtrohen auditimit.

Realizimi i auditimit të entiteteve të sektorit publik, kërkon që raportet të zgjerohen duke raportuar edhe në lidhje me:

- Pajtueshmërinë me kërkesat ligjore e rregullatore
- Përshtatshmërinë e strukturës së kontrollit të brendshëm të entitetit; dhe
- Ekonomicitetin, eficientë dhe efektivitetin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve.

Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) janë institucionet e vetme të përshtatshme për të ofruar një pamje të pavarur rreth cilësisë së menaxhimit të sektorit publik. Për këtë arsye ato duhet të ndërtojnë kapacitetet institucionale dhe profesionale, të tilla që të përfshijnë proceset, aftësitë dhe njohuritë, strukturat dhe metodat e punës të nevojshme dhe që bëjnë të mundur që SAI të realizojë përgjegjësitë audituese.

Standardi i Përgjithshëm i SAI-t 200, është udhërrëfyesi kryesor i KLSH lidhur me politikat e zhvillimit profesional të stafit. Objektivi kryesor i trajnimit të audituesve synon të krijojë auditues kompetentë, profesionalë, të aftë të japin kontribut pozitiv në jetën e tyre profesionale dhe ambientin ku ata ushtrojnë detyrat e tyre.

Trajnimi dhe zhvillimi i audituesve synojnë të sigurojnë një bazë të njohurive, aftësive dhe vlerave profesionale, e cila u mundëson atyre të zhvillohen në vijimësi dhe t'u përshtaten ndryshimeve gjatë gjithë jetës së tyre profesionale.

Sistemi i trajnimit në KLSH tashmë synon të shkojë nga modeli tradicional drejt një modeli të orientuar nga rezultatet. Një model bazuar në vlerën e shtuar është mënyra më e mirë për të vlerësuar përfitimet nga trajnimi i audituesve. Megjithëse nuk ekziston ende një metodë apo mjet për të matur vlerën e shtuar të trajnimit, mënyra më e mirë dhe e përshtatshme mbetet cilësia e punës së audituesve.

Trajnimet në KLSH, të strukturuar sipas modeleve më të përparuar të trajnimit, mbështetur në nevojat aktuale të stafit dhe të prezantuar nga ekspertë profesionistë ofrojnë një kuadër të plotë për audituesit e KLSH se si të implementohen hap pas hapi ISSAI dhe standardet e njohura të kontabilitetit në fazat përkatëse të auditimit.

Konkluzione

- Integriteti i Institucionit Suprem të Auditimit është element thelbësor që ky institucion të konsiderohet i besueshëm;
- Analiza e riskut i shërben auditimit për të përcaktuar prioritetet e tij dhe për të përgatitur tema të reja të propozuara për auditim të cilat lidhen me ato zona ku risku për parregullsi është shumë i lartë;
- Nevoja e adoptimit të IPSAS, fillimisht ato të kontabilitetit monetar (ose të modifikuar) e më pas IPSAS mbi parimet e kontabilitetit rritës;
- Puna e nisur nga IEKA për standardizimin e pasqyrave financiare, mund të shërbejë si një model për auditimin e llogarive të shtetit dhe ndërtimin e një procesi të besueshëm të konsolidimit të informacionit;
- Trajnimi i punonjësve të KLSH-së është një proces i vazhdueshëm dhe duhet të shërbejë aftësimin të audituesve. Ai duhet të jetë një proces zhvillimi dhe faktor kryesor në motivimin e punonjësve.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në mbyllje të punimeve të Konferencës së Dytë Shkencore të KLSH-së, në pasditen e datës 13 dhjetor, bashkëdrejtuesit e Konferencës z.Joop Vrolijk, Këshilltar i Lartë i SIGMA, z. Jacek Jezierski, Këshilltar i Presidentit të Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë (NIK) dhe z.Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhanë konkluzionet e punimeve të kësaj Konference :



Bashkëdrejtuesit e Konferencës : Kryetari i KLSH, z. Bujar Leskaj;Eksperti i SIGMA, z. Joop Vrolijk; Këshilltar i Presidentit të NIK të Polonisë, z. Jacek Jezierski

- * Vetëm auditimet e pavarura dhe profesionale mund të kontribuojmë në mbajtjen e qëndrueshmërisë afatmesme dhe afatgjatë të financave publike, në mbrojtje të interesit publik dhe forcimit të qeverisjes kombëtare;

- * Thellimi në analizën e riskut në planin vjetor të auditimeve dhe marrja e informacionit nga burime të ndryshme, përfshirë dhe shoqërinë civile dhe mediat, ndihmon në përzgjedhjen efikase të subjekteve dhe tematikave për auditimin vjetor;
- * Llogaridhënia menaxheriale, si përbërës thelbësor i mirëqeverisjes dhe vendosja e “tone at the top”, mund të sigurohen nëpërmjet transparencës së plotë të veprimtarisë menaxheriale, delegimit të kompetencave dhe marrjes në këmbim të informacionit;
- * Forcimi i rolit mbikëqyrës të auditimit publik suprem mbi financat shtetërore mund të realizohet me efektshmëri duke zbatuar në praktike ISSAI-t e auditimit financiar, të perputhshmerise dhe të performances, në përshtatje të plote me kushtet e vendit;
- * Rritja e cilësisë së auditimeve të rregullave fiskale kontribuon në mirëfunksionimin e skemës së rregullatorit financiar në vend;
- * Përballimi i sfidave të sotme në auditimin publik lehtësohet dukshëm nga një bashkëpunim konkret dhe në vijimësi i audituesve të brendshëm me audituesit e jashtëm, duke synuar ngritjen e këtij bashkëpunimi deri në nivelin e auditimeve të përbashkëta;
- * Instrumenti INTOSAINIT i vetëvlerësimit ndihmon rritjen e integritetit të SAI-t dhe forcon besueshmërinë e tij në publik, prandaj ai duhet të përdoret më shpesh nga SAI-t;
- * Procesi i integritetit në BE kërkon njohjen e metodikave bashkëkohore të auditimit të fondeve të BE-së;
- * Në kushtet e reja të krijuara, duhet të rrisim përdorimin e mjeteve jo-konvencionale të politikës sonë audituese, duke bashkëpunuar më ngushtë dhe gjerësisht me botën akademike, shoqërinë civile

dhe organizatat profesionale të fushës;

- * Bashkëpunim konkret dhe efikas të strukturave shtetërore me institucione të tjera të angazhuara, në mënyrë që KLSH të garantojë progresin e enteve të audituara drejt zhvillimit të qëndrueshëm, një koncept që evoluon vazhdimisht për shkak të integritimit të çështjeve me karakter social, ekonomik dhe mjedisor;
- * Norma ligjore e riskut dhe vlerësimi i tij në projekte e çdo aktivitet ekonomik- financiar janë kusht i domosdoshëm i auditimit të tyre;
- * Raportet fiskale duhet të ofrojnë një pasqyrë të plotë, relevante, në kohë dhe të besueshëm të pozicionit financiar dhe performancës së qeverive;
- * Kodi i Transparencës Fiskale do t’ju mundësojë vendeve aplikuese të tij një panoramë të qartë mbi praktikat e raportimit fiskal të tyre, duke i krahasuar ato me standardet ndërkombëtare dhe vendet e tjera.

Konferenca e tretë shkencore e KLSH-së do të zhvillohet në muajt shtator-tetor të vitit 2014.

KLSH përruron ekspozitën dokumentare dhe fotografike “Historiku i Kontrollit të Lartë të Shtetit 1925-2013”

Më datë 11 dhjetor 2013, në ambientet e KLSH-së, u përrurua ekspozita dokumentare dhe fotografike “Historiku i Kontrollit të Lartë të Shtetit 1925-2013”. Në ceremoninë e rastit ishin të pranishëm z. Robert Gielisse, Drejtor Njësie në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit (DG-Budget) të Komisionit Evropian, z. Jacek Jezierski, ish-President i Zyrës Kombëtare të Auditimit-NIK të Polonisë, z. Lars Lage Olofsson, Auditues i Përgjithshëm i Kosovës, si dhe përfaqësues të lartë të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë, të Gjykatës së Llogarive të Turqisë, të Institucionit Shtetëror të Auditimit të Malit të Zi, të Zyrës Shtetërore të Auditimit të Maqedonisë dhe këshilltarë të lartë të programit SIGMA.



Në fjalën e tij, Kryetari i KLSH-së, z. Bujar Leskaj nënvizoi vlerat e institucionit ndër vite, si dhe përmendi figurat e njohura themeluese dhe drejtuese të tij në periudhat e ndryshme të historisë së Shqipërisë.

Ai u ndal në kontributin e vyer të dhënë nga shumë auditues të mëparshëm dhe të sotëm të KLSH. Z. Leskaj theksoi faktin se formimi dhe ruajtja e identiteteve të qarta historike të institucioneve kushtetuese i shërben rritjes së kujtesës institucionale, forcimit të Shtetit të së drejtës, si dhe kulturës së respektimit të institucioneve tek ne.



Më tej, Prof. Dr. Kaliopi Naska i njohu të pranishmit me standat e mini-Muzeut, ku prezantoheshin me material të bollshëm dokumentar dhe fotografik periudhat kryesore të punës të Kontrollit të Lartë të Shtetit përgjatë historisë së tij 88 vjeçare, për të ardhur në formën e tij të sotme.



Partnerët e huaj të KLSH vlerësuan dokumentacionin e plotë dhe bënë pyetje të shumta për fazat e ndryshme të zhvillimit të Institucionit.

Ekspozita do të qëndrojë në mënyrë permanente në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe do të pasurohet në vijimësi me dokumente dhe foto të aktiviteteve të institucionit.



Presidenti i Republikës, SH.T.Z.Bujar Nishani dekoroi me “Medaljen e Mirënjohjes”

Z.Joop Vrolijk, Këshilltar i Lartë i SIGMA

Në datën 13 dhjetor 2013, Presidenti i Republikës, z.Bujar Nishani dekoroi me “Medaljen e Mirënjohjes”, z.Joop Vrolijk, Këshilltar i Lartë i SIGMA, “Për kontributin dhe ndihmesën e çmuar në përparimin e Institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”.



*Drejtor i Marrëdhënieve me Jashtë i SAI të Rumanisë, z. Dragos Budulac, Zv/
Auditues i Përgjithshëm i SAI të Maqedonisë, z. Naser Ademi, Kryetar i KLSH, z.
Bujar Leskaj, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, SH.T. Z. Bujar Nishani,
Ekspert i SIGMA, z. Joop Vrolijk, Ambasadori i Mbretërisë së Holandës në
Shqipëri, z. Martin de la Beij, Këshilltar i Presidentit të Zyrës Supreme të Auditimit
të Polonisë (NIK), z. Jacek Jezierski, Zëvendës President i Zyrës Supreme të
Auditimit të Polonisë (NIK), z. Wojciech Kutyla*

Z.Vrolijk ka merita te veçanta për mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë KLSH gjatë dy viteve të fundit, sidomos për rritjen e kapaciteteve të audituesve të tij.

Në ceremoninë e dekorimit mori pjesë Kryetari i KLSH-së z.Bujar Leskaj, Ambasadori i Mbretërisë së Holandës në Republikën e Shqipërisë, z. Martin de la Beij, përfaqësues të SAI-ve partnere, personalitete të botes akademike, profesionistë të fushës së auditimit, etj.

Konferenca e dytë Shkencore organizuar nga KLSH, pati edhe mbështetjen e Programit SIGMA nëpërmjet një ndihmë modeste financiare. Një rol të veçantë në këtë drejtim, si edhe për mbarëvajtjen e Konferencës ka Këshilltari i Lartë i SIGMA, z. Joop Vrolijk.





CV, Joop Vrolijk –SIGMA

Joop Vrolijk është këshilltar i lartë për Financat Publik dhe Auditimin, në programin e OECD / SIGMA, që nga viti 2003. Që nga shtatori 2012, ai gjithashtu mban funksionin e Ndërlidhësit Rajonal për Partneritet Evropiane të Fqinjësisë dhe Programin për Lindjen (ENPI-Lindje). Ai punon në vendet e Ballkanit dhe të Evropës Lindore, në fushën e auditimit të jashtëm, të brendshëm, auditimin e fondeve të BE, menaxhimin financiar dhe kontrollin, inspektimin financiar, si dhe në strukturat

e anti-korrupsion (OLAF). Para detyrës së tij në Sigma, ai ka punuar në Gjykatën e Auditimit të Hollandës në fushën e auditimit financiar dhe në funksione të ndryshme menaxhuese për më shumë se njëzet vjet, si dhe ka marrë pjesë zyrtarisht në grupe të ndryshme pune, kombëtare dhe ndërkombëtare (p.sh. grupi i punës së INTOSAI mbi Kontrollin e brendshëm). Ai është një Kontabilist Publik i Certifikuar dhe ka gradën Master në ekonomi dhe Auditim Qeveritar. Në katër vitet e fundit ai ka bashkëpunuar ngushtë me Institucionet Supreme të Auditimit të Shqipërisë, Armenisë, Bosnje-Hercegovinës, Bullgarisë, Kroacisë, Gjeorgjisë, Rumanisë, si dhe me Shërbimin e Inspektimit Financiar të Moldavisë dhe Ukrainës, lidhur me menaxhimin Financiar dhe kontrollin, Inspektimin Financiar, Strukturat Anti-korrupsion, auditimin e fondeve të BE-së, si dhe auditimin e brendshëm dhe të jashtëm. Në emër të OECD / SIGMA, ai është anëtar i Komitetit Drejtues për Dhënien e Ndihmës për Partneritetet lidhur me Menaxhimin e Shpenzimeve Publike (PEMPAL) për Buxhetimin, si dhe Thesarin dhe Auditimin e Brendshëm.

**Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Ilir Meta
priti në një takim drejtuesin e njësisë së Drejtorisë së
Përgjithshme të Buxhetit në Komisionin Evropian, z. Robert
Gielisse dhe z.Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së**

Kryetari i Kuvendit z. Ilir Meta në takimin që pati në datën 13 dhjetor me z.Robert Gielisse, Drejtor njësie në DG Budget dhe Kryetarin e KLSH-së, z.Bujar Leskaj, vlerësoi rëndësinë e posaçme që kanë instrumentet e kontrollit për të garantuar transparencë në menaxhimin e burimeve publike, në zbulimin e paligjshmërive, ndëshkimin e tyre e për forcimin e shtetit të së drejtës.

Kryetari i Kuvendit z. Ilir Meta tha se ka një vullnet të fortë për të forcuar bashkëpunimin ndërinstytucional, përfshi edhe organin e akuzës,



si faktor kyç për forcimin e shtetit të së drejtës, transparencën, mirëqeverisjen dhe luftën kundër korrupsionit.

Duke mbështetur e njohur kontributin në rritje të veprimtarisë së KLSH-së, z. Meta tha se do të nxiste të gjithë aktorët ligjvënës për të bërë të mundur përmirësimin e kuadrit ligjor të veprimtarisë së KLSH-së, si organ Kushtetues, si nevojë e kohës, por edhe si plotësim i rekomandimit të Progres Raportit për Shqipërinë.

Zoti Robert Gielisse shprehu kënaqësinë e tij për mbështetjen e marrë nga Kryetari i Kuvendit, vlerësoi pjesëmarrjen dhe kontributin e z.Illir Meta në konferencën shkencore të KLSH-së të datës 12 dhjetor, në Tiranë.

Pas përfundimit të Konferencës, z.Gielisse i ka shprehur Kryetarit të KLSH-se vlerësimet e tij pozitive për Konferencën: “ *mendoj qe nëpërmjet organizimit të Konferencës Ju dhe stafi juaj keni arritur sukses. Niveli i përfaqësimit ishte i lartë, kumtesat ishin të gjetura dhe të prezantuara mirë...*”

Ndërsa në Progres-Raportin e BE për vitin 2013, KLSH vlerësohet për herë të parë në këto vite : “*Kontrolli i Lartë i Shtetit e ka përmirësuar performancën e tij, duke adoptuar një manual të ri për auditimin dhe duke kryer më shumë auditime. Ai i paraqiti Parlamentit në muajin Mars një raport vjetor për punën e tij. Ai kreu 177 auditime dhe raporto i dëm ekonomik të shkaktuar nga funksionimi i papërshtatshëm i institucioneve shtetërore në vlerën 97.3 milione euro, nga 50 milionë euro në vitin 2011*”.

Vizita në Muzeun Historik Kombëtar, në Galerinë Kombëtare të Arteve, takimi përmbyllës me pjesëmarrjen e Grupit “Çipini” dhe aktivitete të tjera

Pjesëmarrësit në Konferencën e dytë Shkencore të KLSH-së, veçanërisht përfaqësuesit e SAI-ve partnere ndoqën edhe disa aktiviteteve të tjera në kohën e lirë, pas përfundimit të punimeve të Konferencës si në ditën e parë dhe të dytë të saj.

Në datën 12 dhjetor, pjesëmarrësit patën shume interes dhe vizituan Muzeun Historik Kombëtar, të shoqëruar nga drejtues dhe auditues të KLSH-së dhe guidë në gjuhën angleze. Ata vizituan të gjitha pavijonet e Muzeut si pavijonin e Lashtësisë, të Mesjetës, të Rilindjes, Pavarësisë, Ikonografisë,



Në Galerinë Kombëtare të Arteve, Drejtori i Galerisë, z. Artan Shaban, shoqëroi pjesëmarrësit e Konferencës në vizitën e ekspozitës personale të piktorit Rexhep Ferri.

Etnokulturës, të Luftës Antifashiste dhe Pavijonin e Genocidit Komunist. Vizitorët shfaqën interes të veçantë për periudhën dhe betejat e zhvilluara dhe drejtuara nga Heroi ynë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu.



Pjesëmarrësit patën rastin të vizitojnë gjithashtu në Galerinë Kombëtare të Arteve, në datën 13 dhjetor, ekspozitën e piktorit nga Kosova, Rexhep Ferri, të titulluar “Afër dhe Larg”, në të cilën ishin paraqitur rreth 50 vepra në pikturë, të cilat janë pjesë e krijimtarisë së tij 50 vjeçare.

Pjesëmarrësit u pritën nga Drejtori i Galerisë Kombëtare të Arteve dhe vizituan ekspozitën të shoqëruar nga një guidë profesioniste. Ata vlerësuan ekspozitën dhe u impresionuan nga përdorimi dhe ndërthurja e veçantë e ngjyrave në pikturat e artistit Rexhep Ferri.

Titullimi i ekspozitës “Afër dhe Larg”, vjen si një ndjesi e natyrshme, gjeneruar nga hapësira e zhvillimit të arteve pamore në të dy vendet tona, Shqipëri dhe Kosovë.

Në ambientet e Bar-Restorant Piazza, në datën 12 dhjetor, Kryetari i KLSH-së shtroi një darkë për të gjithë pjesëmarrësit. E veçanta e kësaj mbrëmjeje ishte pjesëmarrja e grupit të baletit “Balerinët e rinj”, të cilët i dhanë shume gjallëri dhe klas mbrëmjes. Grupi performoi gjatë gjithë mbrëmjes me



Mjeshtri i madh i muzikës shqiptare, z. Robert Radoja, në sfond audituesit e KLSH, zj. Brunilda Zeneli dhe z. Muhamed Kavaja

kërcime artistike të mbështetura në folklorin dhe traditën popullore të shumë krahinave të Shqipërisë. Të pranishmit vlerësuan pasurinë e folklorit shqiptar dhe veshjet e bukura tradicionale të kërcimtarëve. Mbrëmja ishte e larmishme dhe artistët përcollën edhe disa kërcime klasike.



*Grupi Folklorik i Vlorës, “Çipini”
duke kënduar këngën për Poloninë në respekt të z.Jacek Jezierski,
ish president i NIK-ut polak
Hotel “Nirvana”, Tiranë, 13 dhjetor 2013*

Në mbrëmjen e datës 13 dhjetor, Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj, organizoi një koktej për të gjithë pjesëmarrësit e Konferencës dhe punonjës të KLSH-së, në ambientet e hotel “Nirvana” me pjesëmarrjen e grupit “Çipini”. Bashkëpunëtorët dhe partnerët e KLSH-së çmuan shumë mikpritjen, organizimin dhe rolin që kanë aktivitetet të tilla në vendosjen, zgjerimin dhe forcimin e lidhjeve njerëzore dhe shoqërore. Prezenca e grupit “Çipini” e gjallëroi shumë atmosferën e mbrëmjes dhe i njohu të pranishmet me vlerat e folklorit shqiptar, sidomos të polifonisë labe.



Drejtuesi i Grupi “Çipini” z. Tomor Lelo, Kryetari i KLSH, z. Bujar Leskaj; Këshilltar i Presidentit të Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë (NIK), z. Jacek Jezierski





*Ulur Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve Hirësia e Tij, Haxhi Baba Edmond Brahimaj, Nga e majta Nazif Çela, Tomor Lelo, Golik Jaupi, Vendim Zyka, Sazan Guri, Bujar Leskaj, Joop Vrolijk, Këshilltar i Lartë i SIGMA-s, Hazim Sabanovic, Administrator Projekti i SAI-t të Suedisë, Dzevad Nekic, zv.Auditues i Përgjithshëm i SAI -t të Bosnje dhe Hercegovinës, Jacek Jezierski, ish-President i NIK-ut polak, Engjëllush Tahiri
Hotel "Nirvana", Tiranë, 13 dhjetor 2013*

Në përmbyllje të aktiviteteve të parashikuara për delegacionet pjesëmarrëse në Konferencë, ishte dhe vizita e datës 14 dhjetor, në qytetin e Krujës, në Muzeun e Heroit Kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeu. Delegacioni polak, ai i Bosnje Hercegovinës si edhe ai rumun, shprehën një interes të veçantë dhe patën përshtypje mbresëlënëse nga vizita në Muze, të cilën patën mundësi ta ndjekin me guidë shoqëruese. Delegacionet gjithashtu vizituan me mjaft kënaqësi tregun e vjetër artizanal dhe qytetin historik.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

AXHENDA

Konferenca e II-të Shkencore Vjetore

“Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit në Menaxhimin e Përgjegjshëm Publik përballë Sfidave Aktuale”

Kjo Konferencë organizohet me inisiativën e Institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit të Shqipërisë dhe mbështetjen e Programit SIGMA



Hotel “Tirana”
Tiranë, 12 - 13 Dhjetor

Dita e parë: E martë, 12 Dhjetor, 10:00 – 17:30

Regjistrimi në Konferencë, 9:00-9:30

Paneli 1 – Moderator z. Joop Vrolijk

- 10:00-10:05** Fjala e hapjes dhe e mirëseardhjes nga z. Bujar Leskaj
(Kryetar i KLSH-së)
- 10:05-10:15** Fjalë përshëndetëse nga z. Robert Gielisse (DG-Budget)
dhe z. Joop Vrolijk (Këshilltar i Lartë i SIGMA-s)
- 10:15-10:30** Fjala përshëndetëse nga z.. Ilir Meta (Kryetar i Kuvendit të
Shqipërisë)
- 10:30-10:55** Z. Robert Gielisse, DG-Budget, *“Përgjegjshmëria
menaxheriale si parakusht për qeverisje të mirë dhe faktor
kryesor për sigurimin e përdorimit të fondeve publike”*
- 10:55-11:20** Z. A. Ömer Karamollaođlu, SAI i Turqisë, *“Roli i Standardeve
ISSAI, për të ndihmuar SAI-t në përmbushjen e rolit të tyre”*
- 11:20-11:45** Z. Jacek Jezierski, SAI i Polonisë, *“Metodat e planifikimit
të auditimit në NIK, duke u bazuar në Analizën e Riskut”*
- 11:45** *Pushim kafe*
- 12:00-12:25** Z. Hazim Sabanoviç, SAI i Suedisë, *“Auditimi i Qeverisë:
eksperienca e Suedisë dhe BosnjeHercegovinës”*
- 12:25-12:45** Z. Neven Mates, Gjykata Evropiane e Llogarive, *“Gjykata
Evropiane e Llogarive dhe Roli i saj në promovimin e
Përgjegjshmërisë së Menaxhimit Publik”*
- 12:45-13:10** Z. Joop Vrolijk, SIGMA , *“Marrëdhëniet mes auditimit të
brendshën dhe të jashtëm”*

13:10-13:35 Z. José Viegas Ribiero, ekspert i SIGMA-s, “*Metoda e re kampionimit në auditimin e fondeve të BE-së*”

13:35 Pyetje dhe Diskutime

14:00 *Pushimi i Drekës*

Paneli 2 – Moderator Z. Robert Gielisse

15:00-15:20 Z. Lage Olofsson, SAI i Kosovës, “*Një bazë profesionale e shëndoshë: Një detyrim për shpërndarjen profesionale!*”

15:20-15:40 Z. Naser Ademi, SAI i Maqedonisë, “*Ndërveprimi mes auditimit të brendshëm dhe atij të jashtëm, në mënyrë të tillë që të kemi një qeverisje më të mirë*”

15:40-16:00 Z. Wojciech Kutyla, SAI i Polonisë, “*Komunikimi mes SAI-ve dhe qytetarëve për të përmirësuar Përgjegjshmërinë Publike*”

16:00-16:20 *Pushim kafe*

16:20-16:40 Z. Erdem Eller, SAI i Turqisë, “*Auditimi i Zbatimit të Rregullave Fiskale nga Gjykata Turke e LLogarive*”

16:40-17:00 Prof. Dr. Znj. Lindita Lati & Dr. Valbona Kapllani, Autoriteti i Konkurrencës dhe Universiteti i Tiranës, “*Efiçenca e Auditimit të Performancës*”

17:00 Pyetje dhe Diskutime

17:30 Myllja e ditës së parë

Dita e dytë: E premte, 13 Dhjetor, ora 9:30 – 17:00

Paneli i 3 – Moderator Zj. Manjola Naço & Z. Rinald Muça, Sc.D

09:30-9:50 Prof. Dr. Z. Jorgji Bollano & Msc. Zj. Elira Hoxha,

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, “*Dinamikat e sotme të Raportimit Financiar*”

- 9:50-10:10** Prof. Assoc. Dr. Z. Hysen Çela & CPA Msc. Zj. Greta Angjeli, Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar & Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, “*Standartet Ndërkombëtare të Auditimit dhe përdorimi i tyre në pasqyrat financiare të Sektorit Publik*”
- 10:10-10:30** Prof. Assoc. Dr. Z. Sazan Guri & Msc. Marianthi Guri, “G&G Group” Institut, “*Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane*”
- 10:30-10:50** Prof. Dr. Z. Omer Stringa, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, “*Auditimi i Performanës në Subjektet Publike Shqiptare*”
- 10:50-11:10** Prof. Dr. Z. Skënder Osmani & Gjovalin Preçi, Fakulteti i Gjeologji Minierave, Universiteti Politeknik i Tiranës, “*Auditimi dhe Menaxhimi i Projekteve*”
- 11:10-11:30** Akademik, Z. Jorgaq Kaçani & Msc. Ildir Dervishi, Universiteti Politeknik i Tiranës, “*Një Qasje e re në Auditimin e Investimeve Publike: Pse EVM?*”
- 11:30-11:50** Dr. Z. Bujar Leskaj dhe Zj. Luljeta Nano, KLSH, “*Instrumenti i vetë-Vlerësimit të Integritetit në një SAI*”
- 11:50** *Pushim Kafe*
- .Paneli i 4 – Moderatore Zj. Luljeta Nano**
- 12:10-12:30** Prof. Assoc. Dr. Zj. Helga Vukaj, KLSH, “*Auditimi i Jashtëm në një Perspektivë Juridike*”
- 12:30-12:50** Prof. Assoc. Dr. Zj. Manjola Naço & Kandidatja PhD Zj.

Blerta Zilja, KLSH & Universiteti i Tiranës, “*Qasja e një SAI drejt rritjes së Transparencës së Taksapaguesve dhe Qeverisjes së Mirë*”

12:50-13:10 Z. Fatos Çoçoli & Zj. Irena Islami, KLSH, “*Forcimi i Rolit Mbikqyrës të Institucioneve Supreme të Auditimit.*”

13:10-13:30 Zj. Albana Agolli & Dr. Z. Edvin Stefani, KLSH, “*Roli i SAI-t në auditimin e proceseve administrative fiskale*”

13:30-14:45 *Pushim*

Paneli i 5 – Moderator Z. Jacek Jezierski

14:45-15:05 Dr. Z. Ermal Yzeiraj & Z. Koço Sokoli, KLSH, “*Roli anti-korrupsion i një SAI*”

15:05-15:25 Z. Bajram Lamaj, KLSH, “*Menaxhimi i Qëndrueshëm dhe rekomandimet e KLSH-së në subjektet e qeverisjes lokale*”

15:25-15:45 Kandidat PhD Z. Erton Kaleshi, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës & Drinold Sema, Mbikqyrës IT UNICEF, “*Sfidat e SAI-t në Auditimin ICT*”

15:45-16:05 Zj. Albana Gjinopulli, KLSH, “*Trajnimi si një Element Kyç në Qasjen Moderne të një SAI*”

16:05-16:30 Pyetje & Diskutime

16:30-17:00 Konkluzione – Z. Joop Vrolijk & Z. Jacek Jezierski

17:00 Mbyllja e Konferencës – Z. Bujar Leskaj

Referuesit në Konferencë

Emër mbiemër

Dr.Bujar Leskaj

Dr.Robert Gielisse

Jacek Jezierski

Neven Mates

Joop Vrolijk

Lage Olofsson

A. Ömer Karamollaolu

Wojciech Kutyla

Naser Ademi

Erdem Eller

Jose Viegas Ribiero

Hazim Sabanovic

Prof. Dr. Jorgji Bollano

Prof. Assoc.Dr. Hysen Çela

Prof.Dr.Skënder Osmani

Prof.Dr.Jorgaq Kaçani

Prof.Assoc.Dr.Sazan Guri

Prof. Dr. Lindita Lati

PhD. Greta Angjeli

Msc.Elira Hoxha

Institucioni, pozicioni

KLSH, Kryetar

DG Budget , Drejtor

SAI i Polonisë, Këshilltar i Presidentit

Gjykata Evropiane e Audituesve,
Anëtar

SIGMA, Këshilltar i Lartë

SAI i Kosovës, Auditues i
Përgjithshëm

SAI Turk, Menaxher Programi

SAI i Polonisë, Zëvendës President

SAI i Maqedonisë, zv/Auditues i
Përgjithshëm

SAI Turk, Auditues i Lartë

SIGMA, Ekspert

SAI i Suedisë, Administrator Projekti

KKK, Kryetar

IEKA, Kryetar

Fakulteti Gjeologji Miniera

Universiteti Politeknik i Tiranës,
Rektor

Instituti “G&G Group”, Drejtor
Ekzekutiv

Autoriteti i Konkurrencës, Kryetare

Universiteti Mesdhetar

KKK, Anëtare

Dr.Valbona Kapllani	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës
Msc.Marianthi Guri	Instituti “ G&G Group”
Luljeta Nano	KLSH, Sekretar i Përgjithshëm
Prof.Assoc.Dr.Helga Vukaj	KLSH, Drejtor i Përgjithshëm
Prof.Assoc.Manjola Naço	KLSH, Drejtor Departamenti
Msc. Blerta Zilja	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës
Fatos Çoçoli	KLSH, Ekspert i Jashtëm
Irena Islami	KLSH, Përgjegjëse Sektori
Albana Agolli	KLSH, Drejtor Departamenti
Gjovalin Preçi	KLSH, Kryeauditues
Dr. Edvin Stefani	KLSH, Auditues i Parë
Dr.Ermal Yzeiraj	KLSH, Drejtor Drejtorie
Koço Sokoli	KLSH, Përgjegjës Sektori
Bajram Lamaj	KLSH, Drejtor Departamenti
Albana Gjinopulli	KLSH, Përgjegjëse Sektori
PhD.Erton Kaleshi	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës
Msc. Drinold Sema	UNICEF, IT
Msc. Ildir Dervishi	KLSH, Auditues i Dytë

***Lista e pjesëmarrësve në Konferencë
Përfaqësues të DG Budget, SIGMA dhe SAI-eve të ndryshme***

<i>Emër mbiemër</i>	<i>Institucioni, pozicioni</i>
Dr.Robert Gielisse	DG Budget , Drejtor
Wojciech Kutyla	SAI i Polonise, Zëvendës President
Jacek Jezierski	SAI i Polonisë, Këshilltar i Presidentit
Grzegorz Haber	SAI i Polonisë, Drejtorja e Marrëdhënieve me Jashtë
Joop Vrolijk	SIGMA, Këshilltar i Lartë
Jose Viegas Ribiero	SIGMA, Ekspert
Neven Mates	Gjykata Evropiane e Audituesve, Anëtar
A. Ömer Karamollaolu	SAI Turk, Menaxher Programi
Erdem Eller	SAI Turk, Auditues i Lartë
Susanne Flynn	Përfaqësuese e FMN në Tiranë
Dzevad Nekic	SAI Bosnje Hercegovinës, zv/ Auditues i Përgjithshëm
Enver Isanovic	SAI Bosnje Hercegovinës, Menaxher i Burimeve Njerëzore
Lage Olofsson	SAI i Kosovës, Auditues i Përgjithshëm
Ibrahim Gjylderen	SAI i Kosovës, Asistent i Audituesit të Përgjithshëm
Qëndresa Mulaj	SAI i Kosovës, Zyrtare për Median
Naser Ademi	SAI i Maqedonisë, zv/Auditues i Përgjithshëm

Branko Smilevski	SAI i Maqedonisë, Drejtor Departamenti
Stana Besovic	SAI Malit të Zi, Shefe Sektori
Slavka Tomic	SAI Malit të Zi, Shefe Sektori
Drasko Novakovic	SAI Malit të Zi, Auditues
Dragos Budulac	SAI i Rumanisë, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë
Hazim Sabanovic	SAI i Suedisë, Administrator Projekti

Përfaqësues të botës akademike dhe shoqërisë civile

<i>Emër mbiemër</i>	<i>Institucioni, pozicioni</i>
Dr.Blerim Çela	Ish-Kryetar i KLSH
Mustafa Kërçuku	Ish-Kryetar i KLSH
Prof. Dr. Jorgji Bollano	KKK, Kryetar
Prof. Assoc.Dr. Hysen Çela	IEKA, Kryetar
Ardiana Bunjaku	SHKÇAK, Drejtore Ekzekutive, Kosovë
Art Navakazi	SHKCAK, Asistent, Kosovë
Prof. Dr. Vjollca Karapici	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës
Prof. Dr.Omer Stringa	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës
Mitro Çela	Publicist
Prof. Dr.Lindita Lati	Autoriteti i Konkurrencës, Kryetare
Dr. Valbona Kapllani	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës
Prof. Dr. Skënder Osmani	Fakulteti Gjeologji Miniera
Teuta Baleta	AMF
Prof. Assoc. Dr. Sazan Guri	Instituti “G&G Group”, Drejtor
Msc.Marianthi Guri	Instituti “G&G Group”
Msc.Blerta Zilja	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i

	Tiranës
Msc. Drinold Sema	UNICEF
Gjon Ndreja	KLSH, Ekspert i Jashtëm
Fatos Çoçoli	KLSH, Ekspert i Jashtëm
Bashkim Spahija	Ish Drejtor Juridik në KLSH
Zyhra Kepi	Ish Audituese në KLSH

Kontrolli i Lartë i Shtetit

<i>Emër mbiemër</i>	<i>Institucioni, pozicioni</i>
Dr.Bujar Leskaj	KLSH, Kryetar
Luljeta Nano	KLSH, Sekretar i Përgjithshëm
Prof.Assoc.Dr. Helga Vukaj	KLSH, Drejtor i Përgjithshëm
Dr. Rinald Muça	KLSH, Drejtor Departamenti
Prof.Assoc.Dr. Manjola Naço	KLSH, Drejtor Departamenti
Xhafer Xhoxhaj	KLSH, Drejtor Departamenti
Albana Agolli	KLSH, Drejtor Departamenti
Dr.Ermal Yzeiraj	KLSH, Drejtor Drejtorie
Bajram Lamaj	KLSH, Drejtor Departamenti
Gëzim Zilja	KLSH, Drejtor Drejtorie
Armanda Begaj	KLSH, Drejtore Departamenti
Rustem Tare	KLSH, Drejtor Drejtorie
Edlira Sako	KLSH, Drejtore Drejtorie
Irena Islami	KLSH, Përgjegjëse Sektori
Koço Sokoli	KLSH ,Përgjegjës Sektori
Sali Agaj	KLSH, Përgjegjës Sektori
Albana Gjinopulli	KLSH, Përgjegjëse Sektori
Kozma Kondakçiu	KLSH, Përgjegjës Sektori
Ibrahim Ndreu	KLSH, Përgjegjës Sektori
Dëshira Huqi	KLSH, Përgjegjëse Sektori
Bedri Çoku	KLSH , Zëdhënës

Bashkim Arizaj	KLSH, Kryeauditues
Muhamed Kavaja	KLSH, Kryeauditues
Gjovalin Preçi	KLSH, Kryeauditues
Albert Thoma	KLSH, Kryeauditues
Fatmir Zilja	KLSH, Kryeauditues
Selfo Zeneli	KLSH, Kryeauditues
